

20222032857

## СОБРАНИЕ НА РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА

### L I G J I BUXHETEVE

#### I.DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

##### Neni 1

#### **Përmbajtja e ligjit**

Me këtë ligj rregullohen procedura për përgatitjen, miratimin, realizimin e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut (në tekstin e mëtejme: shteti) dhe buxhetet e njësive të vetëqeverisjes lokale dhe Qytetit të Shkupit (në tekstin e mëtejme: komunat) dhe njoftimi për realizimin e tyre. Ligji i rregullon edhe rregullat fiskale, themelimin dhe kompetencat e këshillit fiskal, planifikimin buxhetor afatmesëm, menaxhimin e mjeteve të shtetit dhe të komunave, si dhe ndjekjen e rezultateve financiare të ndërmarrjeve publike dhe shoqërive tregtare të themeluara nga shteti dhe komunat, si dhe shoqëritë tregtare të themeluara prej tyre, si dhe përgjegjësinë fiskale dhe bazat e sistemit të integruar informativ për menaxhimin e financave publike.

Dispozitat të këtij ligji nuk kanë të bëjnë me Bankën Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut, përveç nenit 4 të këtij ligji.

##### Neni 2

#### **Përkufizimet**

Nocionet e veçanta të përdorura në këtë ligj e kanë kuptimin si në vijim:

1. **“Buxheti”** është akt i pushtetit qendror (buxhetit të shtetit) dhe pushtetit lokal (buxhetit të komunës) me të cilin planifikohen të ardhurat vjetore dhe prurjet e tjera dhe miratohen shpenzimet vjetore dhe daljet e tjera të shtetit ose të komunës;

2. **“Ndryshimi dhe plotësimi i buxhetit”** është akt i shtetit ose i komunës për ndryshimin e buxhetit të fundit të miratuar në vitin rrjedhës. Buxheti i shtetit përfshin edhe buxhetet e fondeve;

3. **“Buxheti i miratuar”** është buxheti ose buxheti i ndryshuar dhe i plotësuar i miratuar nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut ose nga Këshilli i Komunës;

4. **“Buxheti i vlefshëm”** është buxheti i miratuar në vitin rrjedhës, i cili i përfshin të gjitha ndryshimet e bëra gjatë realizimit të tij në përputhje me këtë ligj dhe Ligjin e Realizimit të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut ose vendimin e realizimit të Buxhetit të komunës;

5. **“Buxheti civil”** është prezantimi i buxhetit në mënyrën e thjeshtë me qëllim që të informohen qytetarët se si krijohet dhe si shpenzohen mjetet e shpërndara;

6. **“Llogaria përfundimtare në formën e Raportit vjetor për zbatimin e Buxhetit”** është akt i shtetit ose i komunës (në tekstin e mëtejme: Llogaria përfundimtare e buxhetit) në të cilin janë prezantuar të ardhurat (e realizuara) të arkëtuara dhe shpenzimet e realizuara të të gjitha llogarive të Buxhetit të shtetit apo të komunës, krahasuar me projeksionet e të ardhurave dhe shpenzimeve të miratuara.

7. **“Plani financiar”** është plani i prurjeve dhe daljeve të shfrytëzuesit buxhetor për vitin e caktuar buxhetor;

8. **”Lizingu financiar”** është marrëveshja e lizingut me të cilën pronësia mundet, por nuk duhet të transferohet nga dhënësi i lizingut te shfrytëzuesi i lizingut;

9. **”Kuota”** është shuma e përgjithshme e mjeteve që shfrytëzuesi buxhetor mund ta shpenzojë në periudhë të caktuar kohore në kuadër të një viti buxhetor;

10. **”Apropriacioni buxhetor”** (në tekstin e mëtejshëm: apropiacioni) është shuma vjetore e së drejtës së shpenzimit të shfrytëzuesit buxhetor për qëllimin e përcaktuar;

11. **”Të drejta e shpenzimit”** është e drejta e shfrytëzuesit buxhetor për t’i marrë dhe t’i paguajë detyrimet deri në nivelin e përcaktuar nga apropiacioni;

12. **”Detyrimi”** është detyrimi i vlerësuar, detyrimi i ndërmarrë, detyrimi i bërë për të paguar dhe detyrimi i maturuar, por i papaguar;

13. **”Detyrimi i vlerësuar”** është qëllimi për të marrë detyrimin që është regjistruar në sistemin e librit kryesor të thesarit;

14. **”Detyrimi i ndërmarrë”** është detyrimi që del nga dokumenti juridik, marrëveshja e lidhur, urdhri ose dokument tjetër detyrues, si dhe nga ligji, akti nënligjor ose vendimi i plotfuqishëm gjyqësor ose administrativ që rezulton me detyrime të ardhshme për pagesë;

15. **”Detyrimi i bërë për pagesë”** është detyrimi i bërë nga veprimet e mëparshme, shlyerja e të cilit pritet të rezultojë në dalje të mjeteve të miratuara. Detyrimi për pagesë ndodh kur kushtet e marrëveshjes ose dokumentit tjetër përmbushen, përkatësisht të mirat janë dërguar ose shërbimet janë kryer;

16. **”Detyrimi i maturuar dhe i papaguar”** është detyrimi që nuk është paguar deri në datën e maturimit të tij. Detyrimi i maturuar dhe i papaguar në bazë të kthimit të taksave publike është detyrimi i ndodhur kur kthimi i taksave publike nuk kryhet në afatin e përcaktuar ligjor;

17. Daljet i përfshijnë shpenzimet dhe daljet e tjera;

18. **”Shpenzimet”** janë pagesat nga buxheti që evidentohen në bazë të parave të gatshme në Pasqyrën e të Ardhurave dhe të Shpenzimeve;

19. **”Daljet e tjera”** janë daljet e buxhetit që evidentohen në bazë të parave të gatshme në Pasqyrën e Mjeteve Financiare dhe të Detyrimeve ose në Pasqyrën e Ngarkimit me Borxh dhe Shlyerjes së Borxhit;

20. Prurjet i përfshijnë të ardhurat dhe prurjet e tjera;

21. **”ë ardhurat”** janë prurjet nga buxheti që evidentohen në bazë të parave të gatshme në Pasqyrën e të Ardhurave dhe të Shpenzimeve;

22. **”Prurjet e tjera”** janë prurjet në buxhetin që evidentohen në bazë të parave të gatshme në Pasqyrën e Mjeteve Financiare dhe të Detyrimeve ose në Pasqyrën e Ngarkimit me Borxh dhe Shlyerjes së Borxhit;

23. **”Subjektet publike”** në kuptim të këtij ligji janë shfrytëzuesit buxhetorë, ndërmarrjet publike dhe shoqëritë tregtare me pronësi dominuese ose të plotë të shtetit ose komunave, institucionet jofitimprurëse të kontrolluara dhe të financuara nga shteti ose komunat dhe Banka Popullore e Republikës të Maqedonisë së Veriut;

24. **”Subjektet e pushtetit të përgjithshëm”** në kuptim të këtij ligji janë institucionet që klasifikohen në Sektorin Shteti (S.13), në pajtim me Klasifikimin Nacional të sektorëve institucionalë të Entit Shtetëror të Statistikës;

25. **”Institucionet jofitimprurëse”** janë subjektet juridike të themeluara me qëllim të prodhojnë mallra ose shërbime për të cilat, sipas karakterit të tyre, nuk lejohen të jenë burim i të ardhurave, fitimit ose të ardhurave të tjera financiare për institucionet që i kanë themeluar, të cilat i kontrollojnë ose i financojnë;

26. **”Shfrytëzues buxhetorë”** janë të gjithë personat juridikë të themeluar nga shteti ose komunat, fondet sociale, komunat, përveç Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut, ndërmarrjeve publike dhe shoqërive tregtare, institucioneve jofitimprurëse, të themeluara nga shteti ose komunat;

27. “**Shfrytëzuesi buxhetor amë**” është shfrytëzuesi buxhetor i cili në mënyrë hierarkike është më i lartë se të gjithë shfrytëzuesit buxhetorë dhe subjektet e tjera publike që janë në kompetencë të tij, përveç Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, i cili është shfrytëzuesi amë buxhetor, i cili në pikëpamje hierarkike nuk është epror për shfrytëzuesit e tjerë buxhetorë dhe subjektet e tjera publike;

28. “Ndarja” është një shfrytëzues buxhetor ose përmbledhje e shfrytëzuesve të ngjashëm buxhetorë;

29. “**Politika**” është fusha e veprimit dhe paraqet grup të programeve me qëllime të përbashkëta të përgjithshme afatmesme ose afatgjata;

30. “**Programi**” është fusha më e ngushtë në kuadër të politikës, që i ndjek qëllimet e përbashkëta specifike afatmesme. Një program mund të ketë një ose më shumë nënprograme;

31. “**Nënprogrami**” është pjesa e përpunuar në mënyrë më të detajuar e programit me qëllime afatshkurtra deri në qëllimet afatmesme dhe përbëhet nga projektet dhe / ose aktivitetet;

32. “**Projekti**” është përmbledhja e detyrave të lidhura në mënyrë të ndërsjellë me qëllime të përcaktuara qartë që duhet të kryhen në periudhë të caktuar dhe në kuadër të shpenzimeve të planifikuara dhe daljeve të tjera; projekti i investimit publik është planifikimi, përkufizimi, buxheti, lidhja e marrëveshjeve, ndjekja dhe përfundimi i investimeve në infrastrukturën shoqërore dhe ekonomike publike;

33. “**Infrastruktura ekonomike publike**” është infrastruktura që promovon aktivitetin ekonomik, të tilla si rrugët, autostradat, vijat hekurudhore, aeroportet, sistemet e prodhimit dhe furnizimit me energji, telekomunikimet, furnizimi me ujë dhe kanalizimi;

34. “**Infrastruktura shoqërore publike**” është objektet dhe hapësirat fizike ku komuniteti mund të ketë qasje në shërbime sociale dhe shërbimet e tjera shoqërore, duke e përfshirë mbrojtjen shëndetësore (dhomat shëndetësore, klinikat dhe spitalet), arsimin dhe trajnimin (shkollat dhe universitetet), banimin social, sigurinë publike dhe drejtësinë (policia, gjykatat dhe burgjet), si dhe institucionet dhe qendrat artistike, kulturore dhe rekreative;

35. “**Aktiviteti**” është përmbledhja e detyrave të lidhura në mënyrë të ndërsjellë me qëllime të përkufizuara qartë dhe nuk mund të përkufizohet si projekt;

36. “**Saldoja buxhetore**” është dallimi ndërmjet të gjitha të ardhurave dhe shpenzimeve të buxhetit;

37. “**Suficiti i buxhetit**” është saldoja pozitive e buxhetit, përkatësisht dallimi pozitiv ndërmjet të gjitha të ardhurave dhe shpenzimeve të buxhetit;

38. “**Deficiti i buxhetit**” është saldoja negative e buxhetit, përkatësisht dallimi negativ ndërmjet të gjitha të ardhurave dhe shpenzimeve të buxhetit;

39. “**Deficiti primar**” është saldoja negative e buxhetit e zvogëluar për pagesat e kamatave;

40. “**Llogaria e vetme e thesarit**” (në tekstin e mëtejme LLVTH) është llogaria në Bankën Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut e hapur nga Ministria e Financave dhe e menaxhuar nga Thesari, nëpërmjet së cilës kryhen të gjitha transaksionet dhe evidentohet arkëtimi i të gjitha hyrjeve buxhetore dhe realizimi i të gjitha daljeve buxhetore;

41. “**Sistemi i llogarisë së vetme të thesarit**” (në tekstin e mëtejme: sistemi i LLVTH) është sistemi i vetëm i llogarive i menaxhuar nga Ministria e Financave, i cili jep pasqyrë të konsoliduar të punës financiare dhe saldojve me para, siguron platformë për menaxhim solid dhe efikas të parave të gatshme dhe nëpërmjet të cilit shfrytëzuesit buxhetorë dhe subjektet e tjera publike kryejnë transaksione dhe i regjistrojnë të gjitha hyrjet dhe daljet e tyre, transferimet dhe transaksionet e tjera të mjeteve me para;

42. “**Sistemi i librit kryesor të thesarit**” është sistemi i evidencës së buxhetit të miratuar dhe ndryshimeve dhe plotësimeve të buxhetit, të gjitha transaksioneve dhe saldove në të gjitha fazat e procesit të realizimit të buxhetit, menaxhimit të parave të gatshme dhe të borxhit, si dhe gjithë punës tjetër financiare të shfrytëzuesve buxhetorë, si dhe transaksioneve me para dhe saldove të subjekteve të tjera publike, të cilat marrin pjesë në sistem në përputhje me këtë ligj ose ligj tjetër;

43. “**Likuiditeti**” është aftësia për t’i paguar në kohë detyrimet në afatin e kontraktuar;
44. “**Ngarkimi me borxh**” është procedura për lëshimin e letrave debitore me vlerë dhe tërheqjen e mjeteve nga huatë ose instrumentet e tjera të huazimit në mënyrën e përcaktuar me ligj;
45. “**Ngarkimi me borxh për likuiditetin**” është tërheqja e mjeteve nga huatë afatshkurtra, lëshimi i letrave me vlerë afatshkurtra ose instrumenteve të tjera për financimin e mungesave të përkohshme të mjeteve në para si rezultat i lëvizjes të paharmonizuar të hyrjeve dhe daljeve në buxhet gjatë vitit fiskal;
46. “**Konsolidimi**” është prezantimi i informatave financiare për shumë subjekte publike sikur t’i takojnë një subjekti; në këtë drejtim në mënyrë të ndërsjellë eliminohen flukset e transferimit, mjetet dhe detyrimet ndërmjet subjekteve të veçanta publike;
47. “**Shpenzimet tatimore**” janë shpenzimet indirekte të bëra nëpërmjet sistemit tatimor dhe doganor, në bazë të dispozitave ligjore që çojnë në uljen ose anulimin e prurjeve për të arritur qëllim të caktuar ekonomik ose social;
48. “**Bartësi i kërkesës**” është subjekti publik që ka kërkesa nga personat e tjerë juridikë ose fizikë në baza të ndryshme;
49. “**Borxhi i pushtetit të përgjithshëm**” përbëhet nga detyrimet e konsoliduara financiare të krijuara në bazë të ngarkimit me borxh nga subjektet e pushtetit të përgjithshëm.
50. “**Buxheti i përgjegjshëm gjinor**” është vlerësim i buxheteve nga pikëpamja gjinore, duke përfshirë perspektivën gjinore në të gjitha nivelet e proceseve buxhetore, planifikimin dhe ristrukturimin e të ardhurave dhe shpenzimeve me qëllim arritjen e barazisë gjinore;
51. “**Deklarata buxhetore e përgjegjshme gjinore**” është dokument për përfshirjen e barazisë gjinore në fushën që mbulon programi i përzgjedhur që është objekt i analizës;
52. “**Treguesit gjinorë**” janë mjete për monitorimin e dallimeve gjinore, ndryshimet gjinore të karakterizuara sipas periudhave të ndryshme kohore dhe matjen e progresit drejt arritjes së qëllimeve të përgjegjshme gjinore.

Neni 3

### Qëllimet dhe parimet buxhetore

(1) Qëllimi kryesor në përgatitjen dhe realizimin e buxhetit është stabiliteti makroekonomik dhe zhvillimi i qëndrueshëm dhe stabil ekonomik nacional.

(2) Parimet në të cilat bazohet planifikimi dhe realizimi i Buxhetit janë:

1. Parimi i përgjegjësisë fiskale nënkupton që buxheti i shtetit dhe komunave të planifikohet dhe realizohet në përputhje me qëllimet fiskale afatmesme, të bazuar në projeksionin real të indikatorëve makroekonomikë, detyrimet e ndërmarra dhe obligimet ekzistuese ligjore dhe mjetet publike që menaxhohen në mënyrën me të cilën sigurohet qëndrueshmëria fiskale afatmesme dhe afatgjatë;

2. Parimi i ekonomizimit, efikasitetit dhe efektivitetit nënkupton që buxheti i shtetit dhe komunave të planifikohet dhe realizohet në mënyrën që do të sigurojë shfrytëzim efektiv dhe efikas të mjeteve publike për t’i arritur qëllimet e përcaktuara;

3. Parimi i gjithëpërfshirjes së buxhetit nënkupton që të gjitha të ardhurat dhe prurjet e tjera dhe të gjitha shpenzimet dhe daljet e tjera të të gjithë shfrytëzuesve buxhetorë futen në buxhetin e shtetit dhe komunave plotësisht pa kurrfarë përshtatjesh ndërmjet tyre, përveç transferimit ndërmjet tyre;

4. Parimi i universalitetit nënkupton që të gjitha të ardhurat dhe prurjet e tjera shfrytëzohen për t’i shlyer të gjitha shpenzimet dhe daljet e tjera të buxhetit të shtetit ose komunave, përveç nëse me këtë ligj ose ligj tjetër ndryshe nuk përcaktohet;

5. Parimi i specifikimit nënkupton që shfrytëzuesit buxhetorë mund të ndërmarrin detyrime dhe të bëjnë pagesa vetëm për qëllimet dhe në shumat e përcaktuara me buxhet, në përputhje me klasifikimet buxhetore;

6. Parimi i bazës së parave të gatshme nënkupton që buxhetet ose planet financiare të shfrytëzuesve buxhetorë të përgatiten dhe realizohen në bazë të parave të gatshme;

7. Parimi i një viti nënkupton që buxheti miratohet për periudhë prej një viti, që përkon me vitin kalendarik;

8. Parimi i buxhetit të balancuar (ekuilibri buxhetor) nënkupton që të ardhurat dhe shpenzimet në buxhetin e shtetit dhe komunave janë të balancuara;

9. Parimi i transparencës nënkupton që buxheti i shtetit dhe komunave, si dhe ndryshimet dhe plotësimet e tij, realizimi dhe dokumentacioni i buxhetit do të botohen në Gazetën Zyrtare ose në Fletën Zyrtare ose në faqen e internetit të Ministrisë së Financave dhe komunave, ndërsa raportet financiare të subjekteve tjera publike do të publikohen në faqet e tyre të internetit;

10. Parimi i menaxhimit të sigurt financiar nënkupton realizimin e buxhetit në përputhje me kontrollin e brendshëm efektiv dhe efikas si proces që zbatohet në të gjitha nivelet e menaxhimit të mjeteve financiare;

11. Parimi i barazisë gjinore nënkupton buxhetimin e përgjegjshëm gjinor, përkatësisht respektimin e barazisë gjinore në planifikimin dhe realizimin e prurjeve dhe daljeve buxhetore.

#### Neni 4

### **Regjistri i Subjekteve Publike**

(1) Ministria e Financave e vendos, e mban dhe e mirëmban Regjistrin e Subjekteve Publike që është i disponueshëm publikisht.

(2) Në Regjistrin e Subjekteve Publike regjistrohen subjektet publike në grupet si vijon: shfrytëzuesit buxhetorë, ndërmarrjet publike, subjektet e tjera publike dhe Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(3) Regjistri i Subjekteve Publike anzhurnohet në mënyrë rrjedhëse.

(4) Çdo subjekt i ri juridik i themeluar direkt ose indirekt nga shteti ose komunat duhet të evidentohet në Regjistrin e Subjekteve Publike.

(5) Për vendosjen dhe mirëmbajtjen e Regjistrit të Subjekteve Publike, Ministria e Financave i merr dhënat e nevojshme pa kompensim nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe institucionet e tjera kompetente.

(6) Formën, përmbajtjen, vendosjen dhe mënyrën e mirëmbajtjes së Regjistrit të Subjekteve Publike i përcakton ministri i Financave.

#### Neni 5

### **Klasifikimet buxhetore**

(1) Klasifikimet buxhetore shfrytëzohen për t'i identifikuar qëllimet dhe burimet specifike të mjeteve buxhetore dhe për t'i prezantuar dhe ndjekur sistematikisht të ardhurat dhe prurjet dhe shpenzimet e tjera dhe daljet e tjera sipas organit kompetent, qëllimit ekonomik, funksionit, programit dhe burimit të financimit.

(2) Klasifikimet buxhetore janë:

1. Klasifikimi organizativ me të cilin klasifikohen shfrytëzuesit buxhetorë në strukturë hierarkike organizative të subjekteve të lidhura dhe të koordinuara reciprokisht (shfrytëzuesi buxhetor amë, ndarja dhe shfrytëzuesi buxhetor) për t'i përcaktuar kompetencat e subjekteve për planifikimin dhe menaxhimin të mjeteve publike dhe të punësuarit për shkak të arritjes së qëllimeve të përcaktuara;

2. Klasifikimi ekonomik i klasifikon të ardhurat dhe prurjet e tjera në përputhje me natyrën dhe shpenzimet e tyre dhe daljet e tjera në përputhje me qëllimin e tyre ekonomik në klasa, grupe, nëngrupe, ndarje dhe kontot themelore;

3. Klasifikimi funksional i klasifikon shpenzimet dhe daljet e tjera të Buxhetit sipas qëllimeve të tyre të përgjithshme dhe konkrete funksionale për të cilat janë të dedikuara, në përputhje me klasifikimin e pranuar ndërkombëtar të përcaktuar nga Kombet e Bashkuara;

4. Klasifikimi i programit përfshin ndarjen e buxhetit në politika, programe, nënprograme dhe projekte ose aktivitete të përkufizuara me dokumentet e planit, në të njëjtën kohë duke i grupuar së bashku të gjitha shërbimet dhe aktivitetet publike me qëllim dhe rezultat të përbashkët nëpër strukturën organizative;

5. Klasifikimi sipas burimeve të financimit i klasifikon të ardhurat dhe prurjet e tjera në grupe në lidhje me llojet dhe qëllimet konkrete të shpenzimeve dhe daljeve të tjera.

(3) Ministri i Financave nga afër i përcakton klasifikimet buxhetore sipas paragrafit (2) pikat 1, 2, 4 dhe 5 të këtij neni.

#### Neni 6

### **Njësitë organizative për çështjet financiare të shfrytëzuesve buxhetorë**

(1) Shfrytëzuesit buxhetorë vendosin njësi organizative për çështjet financiare që kryejnë aktivitete në lidhje me përgatitjen dhe realizimin e buxhetit dhe aktivitetet e tjera në lidhje me menaxhimin e mjeteve për të cilat janë përgjegjës. Këto aktivitete një shfrytëzues buxhetor mund t'i kryejë edhe për shfrytëzuesit e tjerë buxhetorë.

(2) Ministri i Financave i përcakton udhëzimet e përgjithshme, për njësitë organizative për çështjet financiare. Aktivitetet dhe përgjegjësitë e njësisë organizative për çështjet financiare duhet të identifikohen dhe diferencohen qartë, si dhe në kushtet kur një shfrytëzues buxhetor i kryen aktivitetet për shfrytëzuesin tjetër buxhetor.

(3) Dispozitat e përcaktuara në paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni i referohen në mënyrë të barabartë nivelit shtetëror dhe komunal.

(4) Të punësuarit në njësitë organizative për çështje financiare në mesin e shfrytëzuesve të buxhetit, të cilët kryejnë punë për përgatitjen dhe realizimin e buxhetit dhe punët e tjera që dalin nga ky ligj, kanë të drejtë për përsosje të vazhdueshme profesionale dhe për trajnim në tema që kanë të bëjnë me këtë ligj.

(5) Trajnimet sipas paragrafit (4) të këtij neni i organizon dhe i realizon Ministria e Financave nëpërmjet trajnuesve me përvojë pune të përshtatshme mbi 5 vjet në fushë.

(6) Trajnuesit sipas paragrafit (5) të këtij neni kanë të drejtë në kompensim në të holla, lartësia e të cilave caktohet në varësi të kohëzgjatjes në orë, kompleksitetit dhe nevojës për përgatitjen e materialeve për realizimin e trajnimit. Lartësia e kompensimit monetar për trajnuesit përcaktohet me akt të ministrit të Financave.

#### Neni 7

### **Mjetet nga fondet e Bashkimit Evropian**

(1) Ministria e Financave është kompetente për menaxhimin e mjeteve të marra nga Buxheti i Bashkimit Evropian, në përputhje me dispozitat dhe rregullat e Bashkimit Evropian (në tekstin e mëtejshëm: BE) për financimin dhe lidhjen e marrëveshjeve me këtë ligj ose ligj tjetër.

(2) Mjetet nga fondet e BE-së, si dhe bashkëfinancimi nacional, paraqiten në buxhet në programet ose nënprogramet përkatëse.

(3) Republika e Maqedonisë së Veriut, si shfrytëzuese e mjeteve nga fondet e Bashkimit Evropian, vendos sistem për mbrojtjen e interesave financiare të BE-së.

(4) Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, me propozim të ministrit të Financave, me Dekret do ta përcaktojë strukturën e sistemit për mbrojtjen e interesave financiare të BE-së.

## II. DISIPLINA FISKALE

### Neni 8

#### **Implikime fiskale dhe të tjera gjatë propozimit të rregullave dhe akteve**

(1) Përpiluesi i propozim-ligjeve dhe akteve të tjera që i propozon Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe propozuesi i rregullave tjera të miratuara nga Qeveria detyrimisht duhet t'i dorëzojë Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut formularin e plotësuar për vlerësimin e implikimeve fiskale afatmesme të shtetit, komunave dhe subjekteve tjera publike. Vlerësimi i implikimeve fiskale afatshkurtra duhet të përmbajë së paku:

1. Ndryshimet e parashikuara në hyrjet dhe daljet e buxhetit shtetëror, buxhetit të komunave dhe subjekteve të tjera juridike për vitin rrjedhës ose për së paku pesë vitet e ardhshme;

2. Analizë mbi të cilën bazohet vlerësimi i implikimeve fiskale;

3. Propozim për burime të financimit.

(2) Në bazë të formularit të përcaktuar në paragrafin (1) të këtij neni, Ministria e Financave paraqet te Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut mendim për implikime fiskale afatshkurtra.

(3) Nëse shfrytëzuesit buxhetorë propozojnë rregulla të reja, akte dhe obligime të cilat shkaktojnë implikime fiskale në vitet e ardhshme buxhetore, gjatë përpilimit të strategjisë fiskale dhe buxhetit, ato duhet të përfshihen në iniciativa të reja për financim.

(4) Implikimet fiskale të dispozitave të reja, akteve ose obligimeve që nuk janë miratuar nga Qeveria, ndërsa të cilat janë miratuar në bazë të ligjeve dhe akteve të tjera nënligjore dhe për të cilat është marrë mendimin paraprakisht nga Ministria e Financave, duhet të jenë në pajtim me ato ligje dhe aktet të tjera nënligjore.

(5) Me përjashtim të paragrafit (4) të këtij neni, nëse implikimi fiskal i dispozitave të reja, akteve dhe obligimeve që nuk janë miratuar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, i tejkalon implikimet fiskale të ligjeve dhe të akteve të tjera në bazë të të cilave janë miratuar dhe të cilat janë kontrolluar nga Ministria e Financave ato akte dhe format përkatëse për vlerësimin e implikimeve të tyre afatshkurtra duhet të parashtrohen te Ministria e Financave. Ministria e Financave parashton mendim te Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut për implikimet fiskale afatshkurtra.

(6) Në rastin kur dispozitat e reja të propozuara ose aktet kanë implikime të cilat janë në drejtim të avancimit të barazisë gjinore detyrimisht në shtojcë të tyre parashtrohet edhe deklaratë për buxhetim gjinor.

(7) Ministri i Financave nga afër e përcakton formën dhe përmbajtjen e Formularit për vlerësimin e implikimeve fiskale afatshkurtra, ndërsa ministri i Punës dhe Politikës Sociale në pajtim me ministrin e Financave përcakton formën dhe përmbajtjen e deklaratës për buxhetim gjinor.

(8) Ministria e Financave nga propozuesi mund të kërkojë të vlerësojë implikimet fiskale afatgjata në rast të dispozitës me ndikim afatgjatë ose për projekt afatgjatë.

(9) Kryetari i komunës i paraqet implikimet fiskale dhe implikimet të tjera gjatë propozimit të dispozitave dhe akteve te Këshilli i komunës.

## Neni 9

### **Parimet fiskale**

Përpos që duhet të veprojnë në pajtim me parimet buxhetore të përcaktuara në nenin 3 të këtij ligji, Qeveria duhet të realizojë qëllimet e politikave në pajtim me parimet e përgjithshme në vijim, të menaxhimit të përgjegjshëm fiskal (parimet fiskale):

1. Parimi i qëndrueshmërisë së financave publike është mbajtja e deficitit buxhetor dhe borxhit të pushtetit të përgjithshëm në nivel të kujdesshëm dhe të qëndrueshëm, i cili nuk paraqet ngarkim të madh mbi ekonominë, e mbështet rritjen ekonomike në afat të gjatë dhe nuk e rrezikon solvencën në raport me obligimet e ndërmarra për pagimin e shpenzimeve;

2. Parimi i sistemit tatimor të qëndrueshëm, nënkupton se shpenzimi dhe tatimimi janë në pajtim me shkallën racionale të stabilitetit dhe parashikueshmërisë së nivelit të ngarkimit tatimor;

3. Parimi i menaxhimit të kujdesshëm me rreziqet fiskale të cilat rezultojnë nga: lëkundjet makro-ekonomike, garanci të dhëna nga shteti dhe komunitat, prona e ndërmarrjeve publike dhe korporata të tjera publike të themeluara nga shteti dhe komunitat ose në të cilat shteti ose komuna është pronar dominues, partneritet publiko - privat dhe të tjera;

4. Përgjegjësia ndërmjet brezave nënkupton se menaxhimi i politikës fiskale realizohet në mënyrë që ka parasysh ndikimin mbi mirëqenien e gjeneratave aktuale dhe të ardhshme.

## Neni 10

### **Rregulla fiskale**

(1) Buxheti dhe Strategjia fiskale duhet të jenë në pajtim me rregullat fiskale të cilat kanë të bëjnë me deficitin dhe borxhin e përgjithshëm të pushtetit të përgjithshëm.

(2) Deficiti i pushtetit të përgjithshëm për vitin përkatës, nuk guxon të kalojë nivelin prej 3% të Bruto Prodhimit Vendor (BPV) nominal.

(3) Borxhi i përgjithshëm i pushtetit nuk guxon të tejkalojë nivelin prej 60% të BPV-së nominale, ndërsa borxhi publik i garantuar nuk guxon të kalojë 15% të BPV-së nominale.

(4) Nëse niveli i borxhit të pushtetit të përgjithshëm është më i lartë se i përcaktuari në paragrafin (3) të këtij neni, Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut duhet të përpilojë dhe miratojë Strategjinë me masa dhe aktivitete konkrete të cilat në periudhën prej më së shumti pesë vjet do të rezultojnë me zvogëlimin e borxhit në nivelin e përcaktuar me këtë Ligj. Deficiti i pushtetit të përgjithshëm duhet të jetë konsistent me lëvizjen e borxhit të pushtetit të përgjithshëm.

(5) Për Prodhim Bruto Vendor nominal në paragrafin (2) dhe (3) do të përdoren të dhënat e fundit për BPV nominal të realizuar të publikuar nga Enti Shtetëror i Statistikës. Në rastet kur këto të dhëna nuk janë publikuar ende për vitin përkatës, do të përdoren vlerësimet, përkatësisht projeksionet e Ministrisë së Financave nga Buxheti i fundit ose Strategjia fiskale.

(6) Qeveria mund të reterojë nga rregullat e përcaktuara fiskale gjatë ndodhjes së cilës do nga rrethanat e jashtëzakonshme në vijim:

1. katastrofa natyrore dhe tronditje eksterne të cilat ndikojnë në rrezikimin e sigurisë nacionale ose jetën dhe shëndetin e njerëzve;

2. gjendje e jashtëzakonshme dhe/ose gjendje të krizës;

3. goditje të rrepta financiare ose ekonomike, të cilat do të rezultojnë në një rritje reale vjetore negative ose shumë të ulët të PBV-së afër zeros, për tejkalimin e së cilës kërkohet mbështetje e konsiderueshme nga politika fiskale.



(7) Shmangiet nga rregullat fiskale lejohen për realizimin e projekteve investive me ndikim pozitiv në PBV. Shmangiet nuk duhet të kalojnë 0,5% të PBV-së në vit dhe në mënyrë kumulative në periudhë prej pesë vitesh.

(8) Për cilëndo shmangie në pajtim me paragrafin (6) dhe (7) të këtij neni, Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut është e obliguar qartë t'ia arsyetojë Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, me rastin e parashtrimit të Buxhetit të ardhshëm ose Ndryshimit dhe Plotësimit të Buxhetit, përkatësisht Strategjisë Fiskale të parë të ardhshme:

1. shkaqet për shmangien nga rregullat fiskale;
2. masat korrekte të cilat i ndërmerr dhe planifikon t'i ndërmarrë me qëllim respektimin e rregullave financiare de kjo në kuadër të periudhës jo më të gjatë se pesë vjet nga reterimi.

(9) Masat dhe aktivitetet sipas paragrafit (4) dhe (8) të këtij neni, duhet të jenë në pajtim me parimet në vijim:

1. Masat korigjuese dhe aktivitetet duhet të jenë të matshme, të shpërndara në vite dhe të fillojnë të japin efekte më së voni nga viti i ardhshëm buxhetor;
2. Masat korigjuese duhet të jenë proporcionale me madhësinë e shmangieve.

## Neni 11

### **Këshilli fiskal**

(1) Këshilli fiskal është trup i pavarur i cili kryen aktivitete nga fushëveprimi dhe kompetencat e tij, të përcaktuara me këtë ligj dhe për punën e vet përgjigjet para Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut .

(2) Këshilli fiskal, në bazë të pavarur, objektive dhe profesionale, përpilon analiza dhe mendime për:

1. supozimet makroekonomike dhe fiskale të përdorura për përpilimin e Buxhetit të shtetit dhe Strategjisë fiskale;

2. Strategjinë fiskale, Buxhetin e shtetit, Ndryshimit dhe Plotësimit të Buxhetit të shtetit, Raportin gjysmëvjetor për realizimin e Buxhetit, Llogarinë përfundimtare të Buxhetit, Raportin vjetor për ekzekutimin e buxhetit dhe dokumentacionin tjetër të parashtruar në Kuvend Republikës së Maqedonisë së Veriut ose të publikuar në pajtim me këtë ligj;

3. rreziqet fiskale dhe mundësinë për plotësimin e Buxhetit të shtetit dhe Strategjisë fiskale;

4. plotësimin e rregullave fiskale nga ky ligj, si dhe për rreziqet për shmangien nga rregullat fiskale;

5. shkaktimin e rrethanave të jashtëzakonshme të cilat rezultojnë me shmangie të jashtëzakonshme nga zbatimi i rregullave fiskale në pajtim me nenin 10 paragrafi (6) të këtij ligji, si dhe për kushtet për shmangie të përkohshme për reforma strukturore dhe investime në pajtim me nenin 10 paragrafi (7) të këtij ligji;

6. zbatimin e masave korrekte të përmendura në nenin 10 paragrafi (4) dhe (8) të këtij ligji.

(3) Këshilli fiskal mund, me iniciativë të vet, përkatësisht me kërkesë të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut ose Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, të përpilojë edhe analiza edhe mendime për efektet fiskale të propozim - ligjeve të caktuara, si dhe për çështje të tjera në pjesën e politikës fiskale dhe menaxhimit të financave publike;

(4) Analizat dhe mendimet e Këshillit fiskal sipas paragrafit (2) të këtij neni janë pjesë përbërëse e dokumenteve përkatëse gjatë parashtrimit të Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut ose Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut për shqyrtim ose miratim. Nëse ekzistojnë, vërejtje në analizat dhe mendimet e Këshillit fiskal, Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut , nëpërmjet Ministrisë së Financave, detyrimisht duhet të përpilohet përgjigje në të cilën do të arsyetohen shkaqet për shmangiet nga analizat dhe mendimet e Këshillit fiskal, e cila gjithashtu është pjesë përbërëse e dokumentit përkatës.

(5) Të gjitha analizat dhe mendimet e Këshillit fiskal publikohen në ueb-faqen e tij, në afat kohor sa më të shkurtër të mundshëm.

(6) Këshilli fiskal përbëhet nga tre anëtarë, me ç'rast nga një anëtar propozon Akademia e Shkencave dhe Arteve të Republikës së Maqedonisë së Veriut - ASHAM, Enti Shtetëror i Revizionit dhe Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut, ndërsa i emëron Kuvendi. Mandati i anëtarëve të Këshillit Fiskal është 6 vjet, pa të drejtë për rizgjedhje.

(7) Institucionet sipas paragrafit (6) të këtij neni, mund të shpallin konkurs publik për paraqitjen e personave të interesuar të cilët i plotësojnë kushtet e parashikuara me këtë ligj për anëtarë të Këshillit fiskal.

(8) Anëtarët e Këshillit fiskal me punën e tyre veprojnë në mënyrë të pavarur, të paanshme, në pajtim me standardet më të larta profesionale dhe etike. Qëndrimet të cilat i shprehin anëtarët gjatë punës së Këshillit fiskal, ose gjatë ngjarjeve publike në lidhje me aktivitete të Këshillit fiskal, nuk paraqesin qëndrim të institucioneve të cilat i kanë propozuar, ose institucioneve me të cilat janë të lidhur.

(9) Anëtar i Këshillit fiskal mund të jetë person, shtetas i Republikës së Maqedonisë së Veriut, i cili ka reputacion përkatës, së paku arsim të lartë dhe së paku dhjetë vjet përvojë përkatëse profesionale ose akademike në fushën e ekonomisë, financave publike, kontabilitetit dhe revizionit ose fushë tjetër të përafërt.

(10) Anëtar i Këshillit fiskal nuk mund të jetë person:

1. të cilit me aktgjykim të formës së prerë i është shqiptuar gjobë ose sanksion kundërvajtës ndalim i ushtrimit të profesionit, veprimtarisë ose detyrës;

2. i cili është deputet në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, anëtar i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, i punësuar në shfrytëzuesit buxhetor ose në subjekt tjetër publik në nivel shtetëror ose lokal;

3. i cili është anëtar i organit të partisë politike, ose ka qenë bartës i funksionit publik gjatë pesë viteve të kaluara;

4. me përjashtim të pikës 3 të këtij paragrafi, anëtar i Këshillit fiskal mund të jetë profesor universitar ose i punësuar përkatësisht i angazhuar në institucion shkencor - hulumtues, ose i angazhuar përkohësisht në institucion financiar ndërkombëtar.

(11) Funkzioni i kryetarit ose anëtarit të Këshillit fiskal pushon nën kushtet në vijim:

1. me kalimin e mandatit;

2. në rast të vdekjes;

3. në rast të dorëheqjes, të parashtruar me njoftim paraprak me shkrim deri te Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut në afat jo më të shkurtër se një muaj nga dita e njoftimit;

4. në rast të shkarkimit;

(12) Kryetari ose anëtar i Këshillit fiskal shkarkohet nëse:

1. pushon t'i plotësojë disa nga kriteret për emërim për anëtar të Këshillit fiskal të përcaktuara në paragrafin (9) të këtij neni;

2. nuk ka mundësi të ushtrojë detyrat për shkak të paaftësisë trupore ose mentale e cila zgjat më tepër se tre muaj;

3. nuk i kryen detyrat në Këshillin fiskal në vazhdimësi në periudhën prej së paku dy muaj;

4. e humb aftësinë afariste.

(13) Vendim për shkarkimin e anëtarit të Këshillit fiskal miraton Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut, me propozim të 20 deputetëve, pas njoftimit paraprak me shkrim për arsyet e shkarkimit të dorëzuar në Kuvend nga institucioni përkatës sipas paragrafit (6) të këtij neni.

(14) Vendi vakant në Këshillin fiskal plotësohet më së voni në afat prej 60 ditë me emërimin e anëtarit të ri të Këshillit me mandat prej gjashtë vjet, me propozim të institucionit përkatës sipas paragrafit (6) të këtij neni.

(15) Këshilli fiskal miraton Program për punë dhe merr vendime me shumicën e anëtarëve të tij.

(16) Anëtarët e Këshillit fiskal zgjedhin kryetar të Këshillit fiskal. Kryetari i Këshillit fiskal e përfaqëson, menaxhon dhe organizon punën e Këshillit fiskal.

(17) Anëtarët e Këshillit fiskal i kryejnë aktivitetet e veta në Këshill pa themeluar marrëdhënie pune. Për aktivitetin e tyre në Këshillin Fiskal, u përcaktohet kompensim mujor të neto bazës në lartësi të dy neto pagave mesatare të paguara në Republikën e Maqedonisë së Veriut gjatë vitit të kaluar.

(18) Punët lidhur me aktivitetet profesionale dhe administrative-teknike për nevojat e Këshillit Fiskal i kryen Shërbimi Profesional i Këshillit Fiskal. Shërbimi profesional i Këshillit Fiskal ka statusin e personit juridik me seli në Shkup. Puna e Shërbimit Profesional drejtohet nga Udhëheqësi i Shërbimit, i cili e prezanton dhe e përfaqëson atë. Udhëheqësi i Shërbimit Profesional zgjidhet nga radhët e punonjësve të shërbimit, nga anëtarët e Këshillit Fiskal dhe përgjigjet para tyre për punën e tij.

(19) Shërbimi profesional i Këshillit Fiskal përbëhet nga katër analistë për mbështetje profesionale dhe dy punonjës për mbështetje administrative-teknike të punës së Këshillit Fiskal. Organizimi i brendshëm dhe përskrimet e vendeve të punës përcaktohen me Rregullore të miratuar nga Këshilli Fiskal. Për punonjësit e Shërbimit Profesional të Këshillit Fiskal do të zbatohen dispozitat e Ligjit të Nëpunësve Administrativë.

(20) Mjetet për funksionim, përfshirë edhe shpenzimet materiale, të Këshillit fiskal sigurohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut, me propozim të Këshillit fiskal dhe ky vendos në mënyrë të pavarur për përdorimin e mjeteve të siguruara.

(21) Në fillim të vendosjes së Këshillit fiskal, Qeveria është e obliguar të sigurojë kushte hapësinore dhe teknike për realizimin e pa penguar të detyrave nga fushëveprimi i aktiviteteve të Këshillit fiskal, për së paku një vit.

(22) Me qëllim përgatitjen e analizave dhe mendimeve në kuadër të mandatit të vet, Këshilli fiskal ka të drejtë për qasje në informacione relevante dhe të dhëna nga shfrytëzuesit buxhetor dhe subjekte të tjera në nivel shtetëror dhe lokal. Të gjitha subjektet publike janë të obliguara të sigurojnë informacionet e kërkuara në afat prej 15 ditë nga pranimi i kërkesës së Këshillit fiskal. Këshilli fiskal ka të drejtë të bëjë publik subjektet të cilat nuk i respektojnë këto dispozita.

(23) Këshilli fiskal dhe çdo anëtar i tij është përgjegjës para Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut për realizimin e detyrave të përcaktuara me këtë ligj.

(24) Këshilli fiskal parashtron në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut raport për punën e vet së paku një herë në vit deri në fund të muajit maj për vitin rrjedhës për vitin e kaluar. Raporti i cili përfshin edhe raportin për menaxhimin e mjeteve sipas paragrafit (20) të këtij neni, publikohet në ueb-faqen e këshillit fiskal.

### III. PLANIFIKIMI BUXHETOR AFATMESËM

#### Neni 12

#### **Deklarata për politikë fiskale**

(1) Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut paraqet Deklaratë për Politikë Fiskale në Kuvend brenda 100 ditëve pas zgjedhjes së saj. Deklarata publikohet në ueb-faqen e Ministrisë së Financave dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut. Deklarata e politikës fiskale përmban udhëzimet për strategjinë fiskale gjatë mandatit të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut. Ministria e Financave është përgjegjëse për mbështetjen teknike të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut në përgatitjen e deklaratës.

(2) Deklarata për politikë fiskale për periudhë pesëvjeçare duhet të përmbajë së paku:

1. projekcion të bilancit të Buxhetit të shtetit;
2. projekcion të bilancit të buxhetit të qeverisë së përgjithshme;
3. projekcion të borxhit të qeverisë së përgjithshme.
4. njoftim i politikës tatimore që do të udhëheqë Qeveria gjatë mandatit;
5. projekcion për rritjen e PBV-së, shkëmbimin e jashtëm tregtar dhe tregun e punës.

#### Neni 13

### **Planifikim strategjik**

(1) Qeveria do t'i përcaktojë prioritetet strategjike për pesë vitet e ardhshme më së voni deri në 15 dhjetor të vitit aktual, duke marrë parasysh Deklaratën për Politikën Fiskale, parimet dhe rregullat fiskale, Programin e Punës së Qeverisë, Analizën e rezultateve të arritura nga zbatimi i Prioriteteve Strategjike të Qeverisë nga viti paraprak, dokumentet e planifikimit strategjik të zhvillimit, strategjitë sektoriale dhe vlerësimi i kushteve aktuale socio-ekonomike dhe sociale në vend.

(2) Qeveria, bazuar në analizën e kryer, mund të përcaktojë prioritet të ri, të ripërcaktojë prioritet të përcaktuar tashmë dhe të heq prioritet të përcaktuar më parë, në rast të ndryshimeve të rëndësishme në kushtet dhe rrethanat ose gjendjes së jashtëzakonshme.

(3) Shfrytëzuesit amë të buxhetit përgatisin plan strategjik për aktivitetet dhe projektet brenda kompetencave të tyre, duke ndjekur detyrimisht prioritetet strategjike dhe qëllimet prioritare të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut. Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut përgatit plan strategjik për aktivitetet dhe projektet në kuadër të kompetencave të tij, në pajtim me ligjinin për Kuvendin e Republikës së Maqedonisë.

(4) Shpenzimet e nevojshme për zbatimin e aktiviteteve të përfshira në programet, nën-programet, projektet dhe masat e përfshira në planin strategjik duhet të jenë brenda shumave maksimale të shpenzimeve (kufijtë e shpenzimeve) të përcaktuara në Strategjinë Fiskale. Plani strategjik harmonizohet dhe përcaktohet në përputhje me Strategjinë e Rishikuar Fiskale dhe buxhetin e miratuar.

(5) Njësia organizative brenda Sekretariatit të Përgjithshëm të Qeverisë përgjegjëse për koordinimin e procesit të planifikimit strategjik të shfrytëzuesve kryesorë të buxhetit, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave, duhet të paraqesin udhëzime të hollësishme dhe afatet për përgatitjen e planit strategjik.

#### Neni 14

### **Parashikimet makroekonomike**

(1) Parashikimet makroekonomike përgatiten nga Ministria e Financave.

(2) Strategjia fiskale duhet të përgatitet në bazë të parashikimeve realiste makroekonomike dhe fiskale duke ndjekur të dhënat më të fundit statistikore dhe të dhëna të tjera të rëndësishme.

(3) Parashikimet makroekonomike do të përgatiten së paku për pesë vitet e ardhshme.

(4) Strategjia fiskale dhe parashikimet makroekonomike do të publikohen në ueb-faqen e Ministrisë së Financave.

#### Neni 15

### **Plani i të ardhurave dhe hyrjeve e tjera**

(1) Të ardhurat e planifikuara dhe hyrjet e tjera janë baza për përcaktimin e ndarjeve buxhetore.

(2) Ministria e Financave siguron udhëzime në lidhje me planifikimin e të ardhurave dhe monitorimin e ekzekutimit.

(3) Parashikimet e të ardhurave dhe ardhura të tjera si bazë për Strategjinë Fiskale dhe Buxhetin e Shtetit përgatiten nga Ministria e Financave.

(4) Ministri i Financave përshkruan me udhëzime mënyrën e përgatitjes së parashikimeve makroekonomike dhe fiskale dhe procesin e koordinimit ndërmjet njësisë organizative dhe institucioneve në lidhje me projeksionin makroekonomik dhe fiskal.

#### Neni 16

### **Strategjia fiskale**

(1) Strategjia fiskale është dokument i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut i paraqitur deri te Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut në të cilin paraqiten supozimet për parashikimet makroekonomike dhe drejtimit e politikës fiskale për vitin aktual dhe pesë vitet e ardhshme. Strategjia e rishikuar Fiskale është pjesë e dokumentacionit të buxhetit.

(2) Strategjia e fundit fiskale e aprovuar është baza për përgatitjen e dokumenteve të tjera të politikës fiskale, përfshirë ato të paraqitura në institucionet e BE-së.

(3) Ministria e Financave përgatit Strategjinë Fiskale dhe ia paraqet Qeverisë, duke pasur parasysh prioritetet strategjike të Qeverisë dhe propozimet e shfrytëzuesve kryesorë të buxhetit.

#### Neni 17

### **Korniza kohore për përgatitjen e Strategjisë Fiskale**

(1) Ministria e Financave do të publikojë plan me afate kohore për përgatitjen e Strategjisë Fiskale në ueb-faqen e saj më së voni deri 15 janar në vitin rrjedhës.

(2) Ministria e Financave duhet të paraqesë letër qarkore për strategjinë fiskale me udhëzimet për përgatitjen e strategjisë fiskale tek shfrytëzuesit kryesorë të buxhetit në përputhje me kornizën kohore të përmendur në paragrafin (1) të këtij neni.

(3) Shfrytëzuesit amë të buxhetit të shtetit përgatisin parashikime fiskale bazuar në legjislacionin ekzistues dhe detyrimet ekzistuese (në tekstin në vijim: skenari bazë) dhe propozim për projekte të reja dhe detyrime të reja financiare (në tekstin e mëtejme nisma të reja) dhe i paraqesin ato te Ministria e Financave në përputhje me kornizën kohore të përmendur në paragrafin (1) të këtij neni. Ministria e Financave i paraqet te Qeveria skenarin bazë, iniciativat e reja dhe hapësirën fiskale për iniciativa të reja.

(4) Qeveria do të miratojë skenarin bazë dhe iniciativat e reja për financim deri në 15 prill në vitin rrjedhës.

(5) Qeveria do të miratojë Strategjinë Fiskale, duke përfshirë aneks që përmban shumat maksimale të mjeteve të aprovuara (kufijtë e shpenzimeve) për shfrytëzuesit buxhetor amë të buxhetit të shtetit, më së voni deri më 30 prill në vitin rrjedhës dhe atë ia dorëzon Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Këshillit Fiskal. Menjëherë pas miratimit nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Ministria e Financave publikon Strategjinë Fiskale në ueb-faqen e saj.

(6) Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut shqyrton Strategjinë Fiskale jo më vonë se 20 qershor të vitit aktual fiskal.

(7) Nëse ndodhin zgjedhje ose gjendje e jashtëzakonshme në periudhën kohore të përmendur në paragrafët (4) dhe (5) të këtij neni, Ministria e Financave do të publikojë në ueb-faqe plan me afate kohore për përgatitjen dhe miratimin e Strategjisë Fiskale.

## Neni 18

### **Përmbajtja e Strategjisë Fiskale**

(1) Strategjia fiskale duhet të përmbajë së paku përshkrim cilësor dhe sasior të:

1. Lëvizjeve të realizuara makroekonomike për vitin paraprak dhe muajt e kaluar të vitit aktual, si dhe parashikimet makroekonomike për vitin aktual dhe pesë vitet e ardhshme të përgatitura nga Ministria e Financave, përfshirë së paku parashikimet për BPV-në reale dhe nominale, inflacionin, tregtinë e jashtme dhe tregun e punës;

2. Realizim për vitin paraprak dhe për muajt e kaluar të vitit aktual, si dhe parashikimit për vitin aktual dhe për pesë vitet e ardhshëm të parametrave vijues të buxhetit të shtetit dhe buxhetit komunal, përkatësisht: të ardhurat, shpenzimet, bilanci i buxhetit (total dhe primar) dhe financimi, kufijtë e shpenzimeve totale, bilanci i depozitave në fillim të vitit fiskal, garancitë dhe borxhi i përgjithshëm i qeverisë;

3. Krahasim i realizimit të parametrave nga pikat 1 dhe 2 të këtij paragrafi me Buxhetin paraprak dhe Strategjinë fiskale, si dhe shpjegimin cilësor dhe sasior të devijimeve kryesore;

4. Krahasim i parashikimeve të parametrave nga pikat 1 dhe 2 të këtij paragrafi me Strategjinë e mëparshme Fiskale, si dhe shpjegimin cilësor dhe sasior të ndryshimeve kryesore, përfshirë ndryshimet e politikave;

5. Krahasim i BPV-së reale të realizuar dhe të parashikuar, inflacionit, bilancit buxhetor dhe borxhit të përgjithshëm të qeverisë me institucionet e tjera përkatëse vendore dhe ndërkombëtare, si dhe shpjegim të shkurtër të ndryshimeve kryesore, aty ku është e mundur;

6. Mjete maksimale të aprovuara (kufijtë e shpenzimeve) për shfrytëzuesit e buxhetit amë për pesë vitet e ardhshme të buxhetit të shtetit;

7. Përshkrim i secilës politikë dhe program dhe shpjegimi i implikimeve fiskale të nismave të reja për financim;

8. Përmbledhje e aktiviteteve për menaxhimin e borxhit të pushtetit të përgjithshëm, përfshirë strukturën e planifikuar të financimit të deficitit, ripagimet dhe bilancin e depozitave;

9. Rreziqe makro-fiskale, përfshirë rreziqet fiskale në lidhje me detyrimet e mundshme dhe rreziqet specifike me shpjegimin sasior dhe cilësor të efekteve në parametrat kryesorë makroekonomikë dhe fiskalë të përmendur në pikat 1 dhe 2 të këtij paragrafi;

10. Shpjegim për pajtueshmërinë ose devijimin nga rregullat fiskale dhe për devijimet e mundshme nga qëllimet fiskale të përcaktuara në strategjinë e mëparshme fiskale;

11. Përshkrim i përdorimit të ndihmës së para-anëtarësimit në BE;

12. Analiza e qëndrueshmërisë fiskale afatgjatë;

13. Informacion dhe të dhëna të tjera të nevojshme.

(2) Strategjia Fiskale e rishikuar nuk përmban pikën 6 të paragrafit (1) të këtij neni.

## Neni 19

### **Përmbajtja e Qarkores së Strategjisë Fiskale**

(1) Qarkorja e Strategjisë Fiskale përmban:

1. Prioritetet strategjike të Qeverisë;

2. Të dhëna paraprake mbi treguesit makroekonomikë aktualë dhe të parashikuar;

3. Draft skenari bazë për shfrytëzuesit amë të buxhetit për pesë vitet e ardhshme fiskale;

4. Udhëzime për vlerësimet afatmesme të hyrjeve dhe daljeve për skenarin bazë;

5. Udhëzime për përgatitjen e iniciativave të reja të financimit;

6. Informacion tjetër i nevojshëm.

(2) Udhëheqësi i shfrytëzuesit amë të buxhetit është përgjegjës për dhënien e udhëzimeve për përgatitjen e parashikimeve për skenarin bazë dhe iniciativat e reja për financimin e shfrytëzuesve të buxhetit brenda kompetencës së tij.

#### Neni 20

### **Prioritetet dhe procedurat afatmesme për përzgjedhjen e iniciativave-projekteve dhe aktivitetete të reja**

(1) Iniciativat e reja përfshijnë projekte të reja, duke përfshirë projekte për investime publike dhe partneritete publiko-private dhe aktivitete të reja, të propozuara nga shfrytëzuesit kryesorë të buxhetit, përfshirë komunat, në emër të tyre ose në emër të njësisve publike nën kompetencat e tyre, të cilat i përgatisin në përputhje me metodologjinë e përshkruar dhe i paraqesin te Ministria e Financave për shqyrtim dhe vlerësim.

(2) Ministria e Financave i shqyrton projektet dhe iniciativat e reja të propozuara dhe i vlerëson kryesisht nga perspektiva e ndikimit fiskal, rreziqeve dhe qëndrueshmërisë.

(3) Ministria e Financave përgatit një listë përmbledhëse të iniciativave dhe projekteve të reja të rishikuara dhe vlerësuara të propozuara dhe ia paraqet atë Qeverisë, përkatësisht këshillave komunalë.

(4) Iniciativat dhe projektet dhe aktivitetet e reja të vlerësuara rishikohen më tej dhe përparësia e tyre përcaktohet nga një grup punues / komision ndër-sektorial i themeluar nga Qeveria, përkatësisht Këshilli i Komunës.

(5) Lista prioritare e iniciativave dhe projekteve dhe aktivitetete të reja miratohet nga Qeveria, përkatësisht nga Këshilli i Komunës.

(6) Me Ligjin për Ekzekutimin e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut ose Vendimin për Ekzekutimin e Buxhetit të Komunës përcakton aktivitetet dhe projektet që duhet të fillojnë vitin e ardhshëm.

(7) Metodologjia për përcaktimin, përgatitjen, rishikimin, vlerësimin dhe prioritizimin e iniciativave ose projekteve dhe aktivitetete të reja do të miratohet nga Qeveria me propozim të Ministrisë së Financave.

#### Neni 21

### **Iniciativë qytetare**

Shfrytëzuesit amë të buxhetit në nivelin shtetëror dhe komunat në nivelin lokal krijojnë mekanizëm për pjesëmarrjen e qytetarëve në procesin e propozimit të iniciativave të reja, në përgatitjen e planeve strategjike dhe strategjisë fiskale.

## **IV. PËRMBAJTJA E BUXHETIT DHE PLANEVE FINANCIARE**

#### Neni 22

### **Përmbajtja e Buxhetit**

(1) Buxheti i shtetit ose i komunës përbëhet nga pjesa e përgjithshme e buxhetit, pjesa e veçantë e buxhetit dhe pjesa projektuese dhe shumëvjeçare e buxhetit.

(2) Të gjitha të ardhurat dhe hyrjet e tjera dhe të gjitha shpenzimet dhe daljet e tjera janë ose pjesë e Pasqyrës së të ardhurave dhe shpenzimeve, Pasqyrës së mjeteve dhe detyrimeve financiare ose të Pasqyrës për huamarrje dhe pagesë të borxhit.

(3) Ministri i Financave e përshkruan më afërsisht formën dhe përmbajtjen e buxhetit sipas paragrafit (1) të këtij neni.

## Neni 23

### **Pjesa e përgjithshme e Buxhetit**

(1) Pjesa e përgjithshme e Buxhetit i përmban të gjitha hyrjet dhe daljet e buxhetit për vitin fiskal të paraqitura në:

- Pasqyrë e të hyrave dhe shpenzimeve,
- Pasqyrë e mjeteve financiare dhe detyrimeve,
- Pasqyrë e huamarrjes dhe shlyerjes së borxhit.

(2) Pasqyrë e të hyrave dhe shpenzimeve përfshin:

1. Të hyra:

- Të hyra tatimore,
- kontribute sociale,
- transfere dhe donacione,
- të hyra kapitale,
- të hyra nga shitja e të mirave dhe shërbimeve,
- të hyra tjera.

2. Shpenzime:

- shpenzime rrjedhëse,
- transfere rrjedhëse,
- shpenzime kapitale,
- transfere kapitale,
- pagesa interesi,
- shpenzime tjera.

3. Saldo buxhetore si dallim midis të ardhurave dhe shpenzimeve.

(3) Pasqyra e mjeteve dhe detyrimeve financiare:

1. Hyrje nga:

- arkëtimi i huave të dhëna,
- shitja e mjeteve financiare,
- kërkesa të arkëtuara për garanci të dhëna.

2. Dalje për:

- hua të dhëna,
- pajisja me mjete financiare,
- pagesa sipas garancive.

3. Rritja ose zvogëlimi neto i mjeteve dhe detyrimeve financiare si dallim midis hyrjeve dhe daljeve në Kontrollin e mjeteve dhe detyrimeve financiare.

(4) Pasqyra e huamarrjes dhe pagesës së borxhit përfshin:

1. Huamarrje (hyrje).

2. Pagesë të borxhit (pagesa e kryegjësë nga huat dhe letrat me vlerë debitoare të emetuara) (dalje).

3. Huamarrja neto ose pagesa e borxhit neto si dallim midis huamarrjes dhe pagesës së borxhit.

4. Plan për huamarrje nga pika 1 e këtij paragrafi.

(5) Ndryshimi i gjendjes së llogarisë tregohet si diferenca midis hyrjeve dhe daljeve nga Kontrolli i të ardhurave dhe shpenzimeve, Kontrolli i mjeteve dhe detyrimeve financiare dhe Kontrolli i huamarrjes dhe shlyerjes së borxhit.



(6) Pjesa e përgjithshme e buxhetit paraqitet sipas klasifikimit ekonomik dhe klasifikimit të burimeve të financimit.

Neni 24

### **Pjesa e veçantë e Buxhetit**

(1) Pjesa e veçantë e buxhetit përmban shpenzimet dhe daljet e tjera (nga planet financiare) të përdoruesve të buxhetit për vitin fiskal.

(2) Shpenzimet dhe daljet e tjera paraqiten sipas organizimit, programit, klasifikimit ekonomik dhe klasifikimit të burimeve të financimit.

(3) Shfrytëzuesit e buxhetit nga e njëjta ndarje sipas klasifikimit organizativ, paraqiten të grumbulluara, dhe informacione shtesë për përdoruesit individualë të buxhetit janë në dispozicion në dokumentacionin e buxhetit.

Neni 25

### **Pjesa projektuese dhe shumëvjeçare e buxhetit**

(1) Pjesa projektuese dhe shumëvjeçare e buxhetit do të mbulojë të gjitha projektet, përfshirë projektet e investimeve publike, të planifikuara të fillojnë ose mbarojnë në vitin e ri buxhetor ose të vazhdojnë në vitin buxhetor vijues dhe në vitet në vijim, në përputhje me klasifikimin e programit dhe klasifikimin e burimeve të financimit.

(2) Pjesa projektuese dhe shumëvjeçare e buxhetit i përfshin:

1. kohëzgjatjen dhe vlerën e përgjithshme për çdo projekt të theksuar;
2. të gjitha shpenzimet e planifikuara dhe daljet tjera për pesë vitet e ardhshme për çdo projekt të theksuar, si dhe pjesa e mbetur për financim deri në përfundim të projektit;
3. shpenzime të realizuara dhe dalje tjera me vlerësim për vitin rrjedhës.

(3) Për të gjitha shpenzimet dhe daljet tjera për projektet të cilat kofinancohen nga buxheti janë përfshirë në Pjesën projektuese dhe shumëvjeçare të buxhetit.

Neni 26

### **Plani financiar**

(1) Plani financiar i shfrytëzuesit buxhetor përgatitet në pajtim me klasifikimet e buxhetit.

(2) Në bazë të instruksioneve në Cirkularin e buxhetit, shfrytëzuesit buxhetorë i përgatitin propozim planet e veta financiare.

(3) Planet financiare përgatiten në bazë të parave të gatshme.

## **V. PËRGATITJA E BUXHETIT DHE PLANEVE FINANCIARE**

Neni 27

### **Përgjegjësi për përgatitjen e buxhetit**

(1) Ministria e Financave është përgjegjëse për përgatitjen e Buxhetit të shtetit dhe për dërgimin e tij në Qeveri.

(2) Kryetari i komunës është përgjegjës për përgatitjen e buxhetit të komunës dhe për dorëzimin e tij të Këshilli i komunës.

Neni 28

**Baza për përgatitjen e Buxhetit të shtetit**

(1) Bazë për përgatitjen e Buxhetit të është:

1. Deklaratë për politikë fiskale;
2. Prioritete strategjike të Qeverisë;
3. Draft plane strategjike;
4. Strategji fiskale;
5. Shumë maksimale të mjeteve të miratuara (limite shpenzuese) për shfrytëzuesit buxhetorë amë të buxhetit.

(2) Qeveria me propozim të ministrit të Financave miraton plan me afate kohore për përgatitjen e propozimbuxhetit dhe propozim planeve financiare.

Neni 29

**Qarkore buxhetore**

(1) Në bazë të dokumenteve të miratuara sipas nenit 28 i këtij ligji, Ministria e Financave më së voni deri më 1 qershor në vitin rrjedhës dorëzon udhëzime te shfrytëzuesit buxhetorë amë në formë të qarkores buxhetore për përgatitjen e propozim-kërkesës buxhetore. Qarkorja buxhetore publikohet në ueb-faqen e Ministrisë së Financave.

(2) Qarkorja buxhetore i përmban së paku elementet në vijim për përgatitjen e Propozimbuxhetit të shtetit:

1. Informatën për indikatorët makroekonomikë rrjedhës dhe të projektuar;
2. Shumën maksimale të mjeteve të miratuara – limite shpenzuese – për shfrytëzues buxhetorë amë për pesë vitet e ardhshme të përcaktuara nga Qeveria;
3. Drejtime dhe udhëzime për përgatitjen e propozim-kërkesave buxhetore;
4. Kornizën kohore për dorëzimin e propozim-planeve financiare dhe përgatitjen e propozimbuxhetit;
5. Informatat tjera të nevojshme.

(3) Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut, me rastin e përgatitjes së propozimbuxhetit të kërkesës së Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, vepron në përputhje me qarkoren buxhetore të dorëzuar dhe Ligjin për Kuvendin e Republikës së Maqedonisë.

(4) Udhëheqësi i shfrytëzuesit buxhetor amë është përgjegjës për shpërndarjen e shumave maksimale të mjeteve të miratuara – limite shpenzuese – shfrytëzuesve buxhetorë në kuadër të kompetencës së tij.

(5) Udhëheqësi i shfrytëzuesit buxhetor amë e dorëzon qarkoren së bashku me limitet shpenzuese te shfrytëzuesit buxhetor në kuadër të kompetencës së tij.

Neni 30

**Qarkore buxhetore për komunat**

(1) Ministria e Financave dorëzon qarkore te kryetarët e komunave më së voni deri më 30 shtator në vitin rrjedhës, me të cilin jepen drejtimet për përgatitjen e buxheteve të komunave.

(2) Qarkorja buxhetore për komunat i përmban elementet si vijon:

1. Prioritete strategjike të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut;
2. Informatë për indikatorët makroekonomikë rrjedhës dhe të projektuar në pajtim me Strategjinë fiskale;

3. Informacion mbi vlerësimin e të ardhurave në vitin buxhetor dhe për pesë vitet e ardhshme fiskale që do të shpërndahen midis Buxhetit të shtetit dhe komunave;

4. Parametrat e veçantë që do të përdoren për shpërndarjen e pjesës së aprovuar të të hyrave nga Tatimi mbi Vlerën e Shtuar të komunave;

5. Informacionet për dotacione me dedikim, bllok dotacione dhe dotacione të tjera për komunitet, të përcaktuara me ligj, si dhe vlerësime për këto dotacione për pesë vitet e ardhshme;

6. Informatat tjera të nevojshme.

(3) Në bazë të qarkores sipas paragrafit (1) të këtij neni, kryetari i komunës për shfrytëzuesit buxhetorë të buxhetit të komunës i jep udhëzimet dhe afatet kryesore për përgatitjen e propozim planeve financiare.

### Neni 31

#### **Propozim plane financiare të shfrytëzuesve buxhetorë**

(1) Shfrytëzuesit buxhetorë përpilojnë propozim-plane financiare (kërkesa buxhetore) në pajtim me udhëzimet, drejtimet dhe limitet shpenzuese të përmbajtura në Qarkoren buxhetore.

(2) Propozim-planin financiar e përmban së paku këtë:

1. Realizimin e daljeve për vitin paraprak, vlerësimin për realizimin e daljeve për vitin rrjedhës, daljet e planifikuara për pesë vitet e ardhshme në pajtim me Qarkoren buxhetore.

2. Arsyetimin e propozim-planit financiar të shfrytëzuesve buxhetorë i cili përmban së paku:

a) përshkrim dhe kompetenca të shfrytëzuesit buxhetor;

b) arsyetim për qëllimet e vendosura në pajtim me klasifikimin programor të harmonizuara me strategjitë dhe dokumentet afatgjate zhvillimore;

c) baza juridike dhe baza tjera për dalje të planifikuara;

ç) burime të financimit;

d) indikatorë të cilët janë bazë për përlogaritje dhe vlerësim të mjeteve të nevojshme për implementimin e programeve;

dh) treguesit e përgjegjshëm gjinorë dhe identifikimin e të paktën një objektivi gjinor aty ku është e mundur;

e) sqarime tjera dhe dokumente në pajtim me drejtimet dhe udhëzimet në Qarkoren buxhetore.

### Neni 32

#### **Kompetenca dhe përgjegjësia e shfrytëzuesve buxhetorë**

(1) Udhëheqësi i shfrytëzuesit buxhetor është kompetent për përgatitjen e planit financiar dhe është përgjegjës para udhëheqësit të shfrytëzuesit buxhetor amë.

(2) Udhëheqësi i shfrytëzuesit buxhetor amë është kompetent për:

1. shpërndarjen e limiteve shpenzuese për shfrytëzuesit buxhetorë në kuadër të kompetencës së tij;

2. koordinimin, përgatitjen dhe parashtrimin e propozim planeve financiare të shfrytëzuesve buxhetorë në kuadër të kompetencës së tij;

3. ridërgimin e të gjithë materialeve në pajtim me këtë ligj, të dorëzuara nga Ministria e Financave të shfrytëzuesit buxhetorë në kuadër të kompetencës së tij.

(3) Kryetari i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut është përgjegjës për përgatitjen e planit financiar të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në pajtim me ligjin për Kuvendin e Republikës së Maqedonisë.

(4) Udhëheqësi i shfrytëzuesit buxhetorë amë i përfaqëson të gjithë shfrytëzuesit buxhetorë në kuadër të kompetencës së tij në procesin e përgatitjes së buxhetit të shtetit, para Ministrisë së Financave dhe para Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(5) Kryetari i komunës është kompetent për përgatitjen e planit financiar të komunës dhe i përfaqëson shfrytëzuesit buxhetorë në kuadër të kompetencës së tij para Këshillit të komunës në procesin e përgatitjes së buxhetit të komunës.

### Neni 33

#### **Dorëzimi i propozim-planeve financiare të shfrytëzuesve buxhetorë**

(1) Udhëheqësit e shfrytëzuesve buxhetorë amë të buxhetit të shtetit i dorëzojnë propozim-planet financiare të të gjithë shfrytëzuesve buxhetorë në kuadër të kompetencës së tyre, së bashku me draft-planin strategjik në Ministrinë e Financave më së voni deri më 15 gusht në vitin rrjedhës.

(2) Udhëheqësit e shfrytëzuesve buxhetorë amë draft-planin financiar, si pjesë përbërëse e propozim planeve financiare, e dorëzojnë te Sekretariati i Përgjithshëm i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut më së voni deri më 15 gusht në vitin rrjedhës.

(3) Nëse shfrytëzuesi buxhetorë amë me propozim planin financiar nuk ka dorëzuar draft-plan strategjik kërkesa buxhetore do të konsiderohet se nuk është e kompletuar dhe me sugjerim nga Ministria e Financave ajo do të kthehet për ripërpunim me afat të përcaktuar konkret.

(4) Në procedurën e përgatitjes dhe miratimit të propozim-planeve financiare dhe planit strategjik, Kuvendi vepron në pajtim me ligjin për Kuvendin e Republikës së Maqedonisë.

(5) Shfrytëzuesit buxhetorë të buxhetit të komunës i dorëzojnë propozim-planet financiare te kryetari i komunës.

### Neni 34

#### **Propozim-plane financiare në Propozimbuxhetin**

(1) Ministria e Financave e kontrollon harmonizimin e propozim-planeve financiare me drejtimet dhe udhëzimet nga qarkorja dhe me limitet e aprovuara shpenzuese. Ministria e Financave mund të japë drejtime për korigjime të domosdoshme në propozim planet financiare që ato të jenë pjesë e propozimbuxhetit.

(2) Në rast se nuk arrihet pëlqim ndërmjet shfrytëzuesit buxhetor amë dhe Ministrisë së Financave, Ministria e Financave e dorëzon propozim buxhetin në Qeveri në të cilin paraqitet shuma e kërkuar dhe shuma e propozuar nga Ministria e Financave.

(3) Kryetari i komunës bën harmonizim të propozim planeve financiare të shfrytëzuesve buxhetorë të buxhetit të komunës dhe përfshirjen e tyre në propozimbuxhetin e komunës.

## VI. DOKUMENTACIONI BUXHETOR DHE MIRATIMI I BUXHETIT

### Neni 35

#### **Propozimbuxheti dhe dokumentacioni buxhetor**

(1) Propozimbuxheti i shtetit shoqërohet me Propozim-ligjin për realizimin e buxhetit dhe dokumentacionin buxhetor adekuat.

(2) Dokumentacioni buxhetor përshin edhe:

1. Strategji fiskale të reviduar;

2. Arsyetim për Propozimbuxhetin i cili përfshin së paku: realizim nga viti paraprak, realizim të vlerësuar të buxhetit për vitin rrjedhës, Propozimbuxhet dhe projeksione për pesë vitet e ardhshme, si dhe elemente të definuara në nenin 31 paragrafi (2) pika 2 të këtij ligji;

3. Propozim-program vjetor për shitjen e mjeteve jofinanciare të përcaktuara me nenin 75 të këtij ligji;

4. Propozim-program vjetor për shitjen e mjeteve jofinanciare të përcaktuara me nenin 85 të këtij ligji;

5. Pasqyrë përmbledhëse e deklaratve buxhetore gjinore të shfrytëzuesve buxhetorë.

(3) Propozimbuxheti i komunës shoqërohet me Vendim për realizimin e buxhetit të komunës dhe dokumentacionin buxhetor adekuat.

## Neni 36

### **Përmbajtja e Ligjit për realizim të buxhetit të shtetit/Vendimit për realizim të buxheteve të komunave**

(1) Ligji për realizimin e buxhetit të shtetit përmban veçanërisht dispozita për:

1. Shpenzime të miratuara maksimale të buxhetit të shtetit;

2. Rregulla për rishpërndarjen e buxhetit në pajtim me nenin 47 të këtij ligji;

3. Përqindje të detyrimeve të aprovuara për të cilat do të nevojiten pagesa të ardhshme në pajtim me nenin 52 të këtij ligji;

4. Afatet për pagesë për të gjithë shfrytëzuesit buxhetorë në pajtim me nenin 64 të këtij ligji;

5. Shumën maksimale e huamarrjes së buxhetit të shtetit, shumën përmbledhëse maksimale e huamarrjes të të gjithë buxheteve të komunave dhe kufizim të huamarrjes së subjekteve tjerë publike në pajtim me nenin 88 të këtij ligji;

6. shumën e përgjithshme e garancive të sapo lëshuara nga shteti në pajtim me nenin 88 të këtij ligji;

7. autorizime specifike të Qeverisë dhe të Ministrisë së Financave për realizim të buxhetit të shtetit për çdo vit;

8. dispozita tjera të cilat mundësojnë realizim të papenguar të buxhetit të shtetit.

(2) Vendimi për realizimin e buxhetit të komunës përmban veçanërisht dispozita për:

1. Shpenzime të miratuara maksimale të buxhetit të komunës;

2. Dispozitë në pajtim me të cilën ridedikimet e buxhetit të komunës do të jenë në pajtim me dispozitat e ligjit për realizim të buxhetit të shtetit;

3. Shumë maksimale të huamarrjes së buxhetit të komunës në pajtim me ligjin;

4. Shumë të përgjithshme të garancive të sapolëshuara për subjektet publike të cilët janë themeluar nga komuna;

5. Autorizime specifike të kryetarit të komunës për realizim të buxhetit;

6. Dispozita tjera të cilat mundësojnë realizim të papenguar të buxhetit të komunës.

## Neni 37

### **Miratimi i buxhetit të shtetit dhe komunave**

(1) Ministri i Financave, ministritë dhe kryetarët e komunave e prezantojnë Propozimbuxhetin e shtetit përkatësisht propozimbuxhetet e komunave para publikut.

(2) Qeveria e dorëzon Propozimbuxhetin e shtetit, së bashku me Propozimligjin për realizimin e buxhetit dhe dokumentet shoqëruese sipas nenit 35 paragrafi (2) të këtij ligji, në Kuvend më së voni deri më 15 tetor në vitin rrjedhës.

(3) Pas dorëzimit të Propozimbuxhetit në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut dorëzon kopje të të gjitha dokumenteve të theksuara në paragrafin (2) të këtij neni në Këshillin Fiskal.

(4) Seanca e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut mbahet pas kalimit të së paku 20 ditëve nga dita e dorëzimit të Propozimbuxhetit të shtetit në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(5) Ministri i Financave e prezanton Propozimbuxhetin e shtetit në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Me kërkesë të ministrit të Financave ose së paku pesë deputetëve udhëheqësi i shfrytëzuesit buxhetor amë i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut do ta prezantojë Propozimbuxhetin e shfrytëzuesit buxhetor amë në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut së bashku me ministrin e Financave.

(6) Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut e miraton Buxhetin e shtetit për vitin e ardhshëm më së voni deri më 25 dhjetor në vitin rrjedhës.

(7) Pas miratimit të Buxhetit të shtetit nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut, Ministria e Financave në ueb-faqen e vet e publikon me të gjithë dokumentet shoqëruese.

(8) Kryetari i komunës e dorëzon propozimbuxhetin në këshill për miratim, më së voni deri më 15 nëntor në vitin rrjedhës. Këshilli i komunës e miraton buxhetin për vitin e ardhshëm më së voni deri më 25 dhjetor në vitin rrjedhës dhe publikohet në ueb-faqen e komunës.

#### Neni 38

### **Kufizim gjatë miratimit të buxhetit**

(1) Gjatë procedurës për miratimin e Buxhetit, secila rritje e aproprijimit buxhetor të propozuar duhet të shoqërohet me zvogëlim adekuat të aproprijimeve tjera të propozuara në kuadër të burimit të njëjtë të financimit.

(2) Rezervat, mjetet e planifikuara për servisim të borxhit në propozimbuxhetin ose mjetet për të cilat tanimë ka ndërmarrë obligime në vitet paraprake në pajtim me këtë ose ligj tjetër nuk mund të zvogëlohen.

#### Neni 39

### **Financimi i përkohshëm**

(1) Nëse nuk miratohet buxhet para vitit për të cilin ka të bëjë, financimi i shtetit dhe komunave dhe realizimi i kompetencave të tyre dhe detyrime tjera ligjore (në tekstin e mëtejme: financim kohor) duke filluar nga 1 janari i vitit të ri buxhetor, përkohësisht do të bëhet në bazë të buxhetit të vitit paraprak dhe do të zbatohet për qëllimet e njëjta dhe programe/projekte dhe aktivitete si edhe në vitin paraprak.

(2) Gjatë financimit të përkohshëm, mjetet mund të shfrytëzohen deri në nivel prej 90% të mjeteve të shpenzuara gjatë muajit të njëjtë të vitit paraprak, përveç për pagesën e kryegjësë, kamatës, obligimet tjera të cilat dalin nga huamarrja dhe ngjarjet e jashtëzakonshme të papritura të cilat janë kërcënim për sigurinë e vendit ose për jetën e qytetarëve.

(3) Gjatë financimit të përkohshëm, shfrytëzuesit buxhetorë nuk mund ta rrisin numrin e të punësuarve në lidhje me gjendjen më 31 dhjetor të vitit paraprak.

(4) Me përjashtim nga paragrafët (2) dhe (3) të këtij neni, projektet dhe aktivitetet e financuara nga donatorë duhet të vazhdojnë në pajtim me marrëveshjet me donatorët dhe me mjetet e siguruar.

(5) Pas kalimit të financimit kohor, obligimet e paguara në këtë periudhë përllogariten në buxhetin e miratuar të shtetit ose komunës.

(6) Vendimin për financimin kohor në nivel shtetëror e miraton Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut e cila e njofton Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(7) Vendimin për financim kohor në nivel lokal e miraton Këshilli i komunës.

## VII. REALIZIMI I BUXHETIT

### VII.1. Dispozita të përgjithshme

Neni 40

#### Përgjegjësi për realizimin e buxhetit

(1) Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut është përgjegjëse para Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut për realizimin e Buxhetit të shtetit.

(2) Kryetarët e komunave janë përgjegjës para Këshillit të komunës për realizimin e buxheteve të komunave.

(3) Njoftimi për realizimin e buxhetit në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe/ose Këshillin e komunës bëhet në pajtim me nenet 91, 92, 93, 94, 95 dhe 96 të këtij ligji.

(4) Ministria e Financave është e detyruar rregullisht ta ndjek realizimin e buxhetit dhe nëse është e nevojshme në mënyrë adekuate ta njoftojë Qeverinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut për shmangien e realizimit të planit të të hyrave dhe shpenzimeve.

(5) Njësia organizative për çështje financiare te komunat është e detyruar ta ndjek realizimin e buxhetit dhe nëse është e nevojshme në mënyrë adekuate ta njoftojë kryetarin e komunës.

Neni 41

#### Përgjegjësia e udhëheqësit të shfrytëzuesit buxhetor për realizimin e planit financiar

(1) Udhëheqësi i shfrytëzuesit buxhetor është përgjegjës për realizimin e planit financiar të aprovuar të shfrytëzuesit buxhetor.

(2) Udhëheqësi sipas paragrafit (1) të këtij neni mund të autorizojë persona të cilët do të kryejnë aktivitete për arkëtimin e të ardhurave dhe hyrjeve tjera, realizimin e shpenzimeve dhe daljeve tjera të cilat janë në kompetencë të shfrytëzuesit buxhetor. Arkëtimi dhe realizimi përfshijnë edhe rezervimin e mjeteve, ndërmarrjen dhe vërtetimin e obligimeve, lëshimin e urdhëresave për pagim, përcaktimin dhe arkëtimin e kërkesave dhe aktivitete tjera të cilat do të sigurojnë menaxhim dhe kontroll financiar. Autorizimet delegohen në formë të shkruar.

(3) Personat sipas paragrafit (2) të këtij neni duhet t'i realizojnë aktivitetet e këtij neni në pajtim me këtë ose ligj tjetër.

(4) Për realizimin e planit financiar të aprovuar të shfrytëzuesit buxhetor përgjigjen edhe personat e autorizuar sipas paragrafit (2) të këtij neni në pajtim me autorizimet e dhëna.

(5) Përfshirje sipas paragrafit (2) të këtij neni janë shfrytëzuesit buxhetorë të cilët funksion rregullator (trupa rregullator) dhe përdorues tjerë buxhetor të cilët nuk janë në kompetencë të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe të cilët kanë autonomi të realizimit të planeve të tyre financiare të aprovuara në pajtim me rregullat dhe procedurat e rregulluara me këtë ligj.

Neni 42

#### Obligime nga vitet paraprake dhe harmonizime fillestare të buxhetit të miratuar

(1) Shfrytëzuesit buxhetorë duhet të sigurojnë mjete për mbulimin e obligimeve të transferuara nga viti paraprak të cilat nuk janë paraparë me buxhetin e miratuar për vitin rrjedhës, në kuadër të planit financiar personal dhe në pajtim me nenin 47 të këtij ligji.

(2) Shfrytëzuesit buxhetorë duhet t'i përshtatin planet financiare të tyre në afat prej 30 ditë nga fillimi i zbatimit të buxhetit që t'i shlyejnë obligimet financiare nga viti paraprak.

(3) Për përshtatjet sipas paragrafit (2) të këtij neni, Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut e informon Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, përkatësisht kryetari i komunës e informon Këshillin e komunës, më së voni dyzetepesë (45) ditë nga fillimi i zbatimit të buxhetit.

#### Neni 43

### **Harmonizimi dhe miratimi i planeve financiare**

(1) Në rastet kur ndarja ka më shumë se një shfrytëzues buxhetorë, planet financiare të këtyre shfrytëzuesve buxhetorë duhet të harmonizohen me mjetet e miratuara në afat prej tridhjetë (30) ditësh nga fillimi i zbatimit të buxhetit.

(2) Shfrytëzuesi buxhetor amë është përgjegjës për harmonizimin dhe aprovimin e planeve financiare sipas paragrafit (1) të këtij neni. Planin financiar të aprovuar shfrytëzuesi buxhetor amë e dorëzon në Ministrinë e Financave.

(3) Shfrytëzuesi buxhetor amë mund të caktojë shfrytëzues buxhetor në kuadër të kompetencës së tij për aktivitetet sipas paragrafit (1) të këtij neni.

(4) Shfrytëzuesi buxhetor amë dhe shfrytëzuesit buxhetorë të cilët nuk i respektojnë dispozitat sipas paragrafit (1) të këtij neni nuk mund t'i shfrytëzojnë mjetet.

(5) Në nivel lokal, njësia organizative për çështje financiare në komunën është përgjegjëse për harmonizim, ndërsa kryetari i komunës për aprovimin e planeve financiare të shfrytëzuesve buxhetorë në komunën.

### **VII.2. Hyrjet, daljet dhe planifikimi i likuiditetit të buxhetit**

#### Neni 44

### **Arkëtimi i të ardhurave dhe hyrjeve të tjera**

(1) Arkëtimi i të ardhurave dhe hyrjeve të tjera bëhet në pajtim me ligjin, pa marrë parasysh shumën e planifikuar në buxhetin.

(2) Shfrytëzuesit buxhetorë të cilët janë të autorizuar me ligj t'i paguajnë të ardhurat dhe hyrjet tjera nga buxheti, si dhe shfrytëzuesit buxhetorë të cilët realizojnë të ardhura nga puna në kuadër të kompetencës së tyre janë përgjegjës për arkëtimin e tyre të plotë dhe në kohë.

(3) Shfrytëzuesi buxhetorë amë e ndjek arkëtimin e të ardhurave dhe hyrjeve tjera si dhe të ardhurave dhe hyrjeve tjera të arkëtuara në llogaritë e shfrytëzuesve buxhetorë në kuadër të kompetencës së tij.

(4) Të ardhurat dhe hyrjet tjera të Buxhetit të shtetit dhe buxhetet e komunave paguhet në ETC.

#### Neni 45

### **Dalje dhe alokime sipas tremujorëve për qëllim likuidues**

(1) Pas fillimit të zbatimit të buxhetit, Ministria e Financave në bashkëpunim me përdoruesin buxhetor amë, cakton kuota sipas tremujorëve ose periudhë tjetër për shfrytëzim të mjeteve.

(2) Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut me vendim i miraton kuotat në nivel të shfrytëzuesve buxhetorë amë me propozim të Ministrisë së Financave.



(3) Shfrytëzuesi buxhetor amë ua shpërndan kuotat sipas paragrafit (2) të këtij neni shfrytëzuesve buxhetorë në kuadër të kompetencës së tij. Shfrytëzuesit buxhetorë mund të paguajnë vetëm deri në shumën e përcaktuar me kuotën.

(4) Rritja e kuotës së shfrytëzuesit buxhetor amë mund të aprovohet nga Ministria e Financave, nëse kuota zvogëlohet në shumë të njëjtë të përdoruri tjetër amë ose nëse të ardhurat e arkëtuara buxhetore janë më të larta se ato të vlerësuara fillimisht.

(5) Me përjashtim të paragrafit (4) të këtij neni Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut mundet me vendim ta ndryshojë kuotën sipas paragrafit (1) të këtij neni, me propozim të Ministrisë së Financave.

(6) Kryetari i komunës është kompetent për përcaktimin dhe menaxhimin e kuotave në kuadër të buxhetit të komunës.

(7) Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut me vendim i miraton kuotat për Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut me propozim të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Kryetari i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut ose personat e autorizuar në pajtim me nenin 41 paragrafin (2) të këtij ligji janë përgjegjës për përcaktimin dhe menaxhimin e kuotave në kuadër të buxhetit të Kuvendit.

Neni 46

### **Planifikimi i likuiditetit të buxhetit**

(1) Ministria e Financave e planifikon likuiditetin e buxhetit nëpërmjet parashikimit të rrjedhës së parave të gatshme të buxhetit në bazë të të ardhurave të projektuara të buxhetit dhe të hyrave tjera dhe të planeve të parashtruara mujore për realizimin e buxhetit të shfrytëzuesve amë të buxhetit.

(2) Plani mujor për realizimin e buxhetit të shfrytëzuesit amë buxhetor përbëhet nga shpenzimet e planifikuara përmbledhëse dhe daljet dhe të ardhurat tjera dhe të daljet e të gjithë shfrytëzuesve buxhetorë në kompetencë të saj për muaj të caktuar. Planet mujore për realizimin e buxhetit dorëzohen së paku shtatë ditë para fillimit të muajit.

(3) Shuma maksimale e të ardhurave të planifikuara mujore dhe daljet tjera e përcakton Ministria e Financave në pajtim me likuiditetin e disponueshëm buxhetor më së voni në ditën e fundit nga muaji vijues për muajin e ardhshëm.

(4) Njësia organizative për çështje financiare të komunat është kompetente për planifikimin e likuiditetit të buxhetit të komunës nëpërmjet parashikimit të rrjedhës me para të gatshme në bazë të të ardhurave të vlerësuara dhe të hyrje tjera dhe shpenzime të planifikuara dhe derdhjet tjera të shfrytëzuesve buxhetor të komunës për periudhën në vazhdim.

(5) Ministri i Financave për së afërmi e përcakton mënyrën e planifikimit të likuiditetit të buxhetit.

### **VII.3. Rishpërndarja e mjeteve**

Neni 47

#### **Fleksibiliteti buxhetor**

(1) Aproprijimet buxhetore nuk mund të rialokohen përveç në kushte dhe në mënyrë të paraparë me këtë ligj, Ligjin e Realizimit të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Vendimin për realizimin e buxhetit të komunës.

(2) Me përjashtim të paragrafit (1) të këtij neni, nuk është e lejuar rishpërndarja e mjeteve të buxhetit ndërmjet pasqyrës për të ardhura dhe shpenzime, pasqyrës për mjete financiare dhe obligime dhe pasqyrës për huamarrje dhe pagesë të borxhit.

(3) Me kusht kur nuk mundet të respektohen dispozitat e paragrafëve (1) dhe (2) të këtij neni, i qaset procedurave për balancimin e buxhetit sipas nenit 60 ose ndryshimin edhe plotësimin e buxhetit sipas nenit 61 të këtij ligji.

(4) Me përjashtim të paragrafit (3) të këtij neni, çdo vendim formal i Këshillit të komunës për rialokim të aproprijimeve në pajtim me këtë ligj ose ligj tjetër, sipas natyrës së vet në pajtim me këtë ligj konsiderohet për vendim për ndryshimin dhe plotësimin e buxhetit.

#### Neni 48

### **Rishpërndarja e mjeteve për pagesën e kryegjësë, kamatave dhe garancive**

(1) Detyrimet dhe huamarrjet e tjera në lidhje me pagesën e borxhit të shtetit ose komunave që rrjedhin nga marrëveshjet e lidhura të huas, marrëveshjet e garantuara të lidhura, letrat me vlerë debitoare dhe instrumentet e tjerë të huazimit në një mënyrë të përcaktuar me ligj, kryhen pavarësisht nga ndarjet e aprovuara për këtë qëllim në buxhetin e shtetit ose komunës.

(2) Si përjashtim të nenit 47 paragrafi (2) të këtij ligji, Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut ose Këshilli i Komunës mund t'i rishpërndajë mjetet për përmbushjen e detyrimeve të përmendura në paragrafin (1) të Pasqyrës së të ardhurave dhe të shpenzimeve.

(3) Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut e njofton Kuvendin për rishpërndarjen e mjeteve të përmendura në paragrafin 2 të këtij neni brenda 30 ditëve nga rishërndarja.

#### Neni 49

### **Rishpërndarja e mjeteve për pagimin e vendimeve gjyqësore**

(1) Detyrimet në lidhje me vendimet dhe marrëveshjet përfundimtare të gjykatës realizohen nga mjetet e buxhetit në nivelin e shfrytëzuesit buxhetor amë përkatës, pa marrë parasysh mjetet e planifikuara për këtë qëllim.

(2) Qeveria mund të rishpërndajë mjetet ndërmjet shfrytëzuesve kryesorë të buxhetit ose Këshillit Komunal midis shfrytëzuesve të buxhetit për të përmbushur detyrimet sipas paragrafit (1) të këtij neni nga Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve.

(3) Në kushte kur nuk mund të respektohen dispozitat e paragrafit (1) të nenit 47, do të fillojnë procedurat për balancimin e buxhetit në pajtim me nenin 60 ose ndryshimin dhe plotësimin e buxhetit në pajtim me nenin 61 të këtij ligji.

(4) Ministri i Financave e përcakton mënyrën e realizimit të buxhetit dhe rishpërndarjen e mjeteve në rast të vendimeve gjyqësore dhe marrëveshjeve.

## **VII.4. Ndërmarrja e obligimeve**

#### Neni 50

### **Ndërmarrja e obligimeve në buxhet për vitin rrjedhës**

(1) Shfrytëzuesi buxhetor ndërmerr detyrim me lidhjen e marrëveshjes, duke nënshkruar ose lëshuar një dokument me karakter të marrëveshjes ose me miratimin e aktit juridik individual.

(2) Obligimi që shkakton shpenzime dhe/ose dalje të tjera nga buxheti dhe bazohet në ligj, akti nënligjor ose vendimi të plotëfuqishëm gjyqësor ose vendim administrativ, gjithashtu do të konsiderohet si obligim i ndërmarrë.

(3) Para ndërmarrjes së detyrimit të ri në pajtim me paragrafin (1) të këtij neni, shfrytëzuesi i buxhetit duhet të kontrollojë nëse ka mjete në dispozicion brenda ndarjes përkatëse të buxhetit të buxhetit aktual dhe / ose mjeteve tjera në dispozicion sipas këtij ligji apo ligjit tjetër.

(4) Shfrytëzuesi buxhetor nuk mund të ndërmarrë detyrim mbi aproprijimet e alokuara dhe mjetet përkatëse në dispozicion.

(5) Shfrytëzuesi buxhetor doemos duhet të lidh marrëveshje, të nënshkruajë ose të lëshojë dokument tjetër që ka karakterin e marrëveshjes për prokurimin e mallrave dhe shërbimeve.

(6) Shfrytëzuesi buxhetor me përjashtim të paragrafit (5) të këtij neni, mund të lidh marrëveshje, të nënshkruajë ose të lëshojë dokument tjetër për bashkëfinancimin e projektit ose program të bashkëfinancuar nga BE-ja ose fondet e donatorëve edhe pas fillimit të zbatimit të projektit ose programit.

(7) Në rast kur më shumë shfrytëzues buxhetorë sigurojnë mjete për projekt apo aktivitet të caktuar, mund të lidhet vetëm një marrëveshje shumëpalëshe. Nëse nuk parashikohet ndryshe me marrëveshjen, nënshkruesi i parë do t'i koordinojë punët dhe do të verifikojë nëse ka mjete në dispozicion brenda ndarjes buxhetore përkatëse të buxhetit të vlefshëm të të gjithë nënshkruësve.

(8) Shfrytëzuesi buxhetor i evidenton obligimet në sistemin e librit kryesor të thesarit brenda pesë ditësh pune nga dita e ndërmarrjes së detyrimit.

(9) Ministri i Financave për së afërmi i përcakton mënyrën e ndërmarrjes së detyrimeve në pajtim me këtë nen.

#### Neni 51

### **Ndërmarrja e obligimeve në buxhetet për vitet në vijim**

(1) Shfrytëzuesi buxhetor në masën e përcaktuar me Ligjin e Realizimit të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut ose vendimin për realizimin e buxhetit të komunës, mund të ndërmarrë detyrime që mund të shkaktojnë pagesa në vitet e ardhshme.

(2) Para ndërmarrjes së obligimit që kërkon pagesa në vitet e ardhshme, shfrytëzuesi i buxhetit do të kërkojë deklaratë nga Ministria e Financave mbi disponueshmërinë e të drejtave për shpenzim.

(3) Ndryshimet në dinamikën e pagesave që dalin nga detyrimi i ndërmarrë raportohen menjëherë në Ministrinë e Financave.

(4) Pagesat që dalin nga detyrim i ndërmarrë në pajtim me këtë nen planifikohen dhe transferohen në buxhet për vitin në të cilin ato maturohen për pagesë.

(5) Kufizimet sipas paragrafit (1) të këtij neni nuk do të zbatohen për detyrimet në lidhje me borxhet e shtetit ose komunës, menaxhimin e borxhit të shtetit ose komunës dhe për projektet e financuara nga fondet e BE-së për të cilat nevojitet bashkëfinancim.

(6) Ministri i Financave për së afërmi e përcakton mënyrën e ndërmarrjes së obligimeve shumëvjeçare ose për ndryshimin e një prej elementeve kryesore të atyre detyrimeve të ndërmarra tashmë në përputhje me këtë nen.

#### Neni 52

### **Parakushtet për fillimin e prokurimeve publike**

(1) Para fillimit të procedurës së prokurimit publik, mjetet për detyrimin e vlerësuar rezervohen brenda buxhetit të aprovuar për vitin aktual, dhe mundësitë për transferimin e detyrimeve në buxhetet për vitet në vijim konfirmohen në pajtim me dispozitat të këtij ligji.

(2) Ministri i Financave e përshkruan në mënyrë më të detajuar mënyrën e disponueshmërisë së të drejtave të shpenzimeve në buxhet para fillimit të procedurës së prokurimit publik.

## **VII.5. Përfshirja e hyrjeve dhe daljeve të paplanifikuara në buxhet**

### **Neni 53**

Përfshirja e detyrimeve bazuar në akte të reja legislative ose projekte ose aktivitete të reja në buxhet

(1) Pas miratimit të buxhetit, nëse miratohet një ligj i ri ose akt nënligjor i cili nuk parashikohet në planin vjetor i cili sjell detyrime të reja buxhetore, Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut ose Kryetari i Komunës i përfshijnë detyrimet e theksuara në buxhet me rishpërndarje të aproprijimeve në pajtim me nenin 47 të këtij ligji ose me shfrytëzimin e rezervës së përgjithshme buxhetore në pajtim me nenin 59 të këtij ligji.

(2) Aproprijimet buxhetore nuk mund të rishpërndahen për të ndërmarrë detyrime për projekte të reja ose aktivitete në buxhet për të cilat nuk janë siguruar ndarje buxhetore përveç në kushte dhe në një mënyrë të përcaktuar me këtë ligj ose ligjin për realizimin e buxhetit ose vendimin për zbatimin e buxhetit komunal.

### **Neni 54**

## **Hyrjet dhe daljet e dedikuara në buxhet**

(1) Të hyrat e dedikuara dhe hyrjet e tjera të buxhetit përfshijnë donacione, grante, ndihmë, dëmshpërblime të sigurimeve, të ardhura nga aktivitetet vetanake të shfrytëzuesve të buxhetit dhe flukse hyrëse nga hua të caktuara, si dhe lloje të tjera të të ardhurave dhe hyrjeve të buxhetit të parashikuara si të dedikuara me Ligjin për realizimin e buxhetit ose me ligj tjetër .

(2) Shpenzimet e dedikuara dhe daljet e tjera nënkuptojnë shpenzimet buxhetore dhe daljet e tjera të financuara nga të ardhurat me dedikim dhe hyrjet tjera.

(3) Shfrytëzuesit e buxhetit, ndërmarrjen e detyrimeve të financuara nga të ardhurat e destinuara dhe hyrjet e tjera nga buxheti e kryejnë në pajtim me nenet 50 dhe 51 të këtij ligji.

(4) Shfrytëzuesit e buxhetit pagesën e shpenzimeve të dedikuara dhe daljeve tjera nga buxheti e kryejnë vetëm deri në shumën e të ardhurave të arkëtuara me dedikim dhe hyrjeve tjera.

(5) Nëse të ardhurat e dedikuara realizohen në shumë më të madhe krahasuar me dinamikën e planifikuar ose përcaktohen të ardhura të reja me dedikim gjatë vitit, Ministria e Financave deri në shumë të përcaktuar me Ligjin për realizimin e buxhetit, përkatësisht Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut mund të vendosë ta përfshijë atë në buxhetin e miratuar me aproprijim përkatës buxhetor mbi shumën e përcaktuar me Ligjin për realizimin e buxhetit dhe për këtë e informon Kuvendin.

(6) Nëse të ardhurat e dedikuara të shfrytëzuesve buxhetorë rregullatorë dhe shfrytëzuesve buxhetorë që nuk janë nën kompetencën e Qeverisë, realizohen në shumë më të madhe në lidhje me dinamikën e planifikuar ose përcaktohen të ardhura të reja me dedikim gjatë vitit, ato mund të përfshihen në buxhet me aproprijim përkatës buxhetor dhe për këtë e njofton Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(7) Të hyrat e destinuara dhe flukset hyrëse të tjera që nuk përdoren në vitin aktual, përfshirë të hyrat e tjera që janë realizuar në një shumë më të madhe krahasuar me dinamikën e planifikuar ose janë përcaktuar rishtazi gjatë vitit, transferohen në buxhetin e vitit pasardhës, përveç nëse ndryshe nuk është rregulluar me ligjin për realizimin e buxhetit. Ato mund të përdoren vitin e ardhshëm deri në shkallë të mjeteve të planifikuara në planet financiare të shfrytëzuesve të buxhetit.

(8) Hyrjet dhe daljet e destinuarat që i referohen buxhetit komunal ndërkaq realizohen në shumë më të madhe në lidhje me dinamikën e planifikuar ose përcaktohen të ardhura të reja me dedikim gjatë vitit, ato mund të përfshihen në buxhet me apropijum përkatës buxhetor pas vendimit të miratuar paraprak nga Këshilli i Komunës, me propozimin e Kryetarit të Komunës.

(9) Ministri i Financave për së afërmi e përcakton mënyrën e përfshirjes së të hyrave dhe shpenzimeve të caktuara në buxhet dhe përcakton qëllimet për përdorimin e të ardhurave nga aktivitetet vetanake të shfrytëzuesve buxhetorë.

#### Neni 55

### **Kthimi i mjeteve të paguara gabimisht**

(1) Nëse mjetet paguhen gabimisht, personi përgjegjës i shfrytëzuesit të buxhetit menjëherë përcakton kërkesat dhe ndërmerr aktivitete për kthimin e mjeteve të paguara.

(2) Për arkëtimin në vitin e njëjtë financiar, korrigjohet realizimi i daljeve të shfrytëzuesve buxhetorë nga plani financiar i të cilit është bërë pagesa.

(3) Arkëtimi i mjeteve që janë paguar gabimisht në vitet e mëparshme janë të ardhura të jashtëzakonshme.

(4) Nëse donacioni nuk është shfrytëzuar në mënyrë dhe në kushtet e përcaktuara nga donatori, shfrytëzuesi i buxhetit duhet të sigurojë mjete nga plani i tij financiar ose nga plani financiar i shfrytëzuesit të buxhetit amë, për kërkesën nga ana e donatorit në këtë bazë.

(5) Nëse mjetet e BE-së nuk përdoren në mënyrë dhe nën kushtet e përcaktuara në marrëveshjen përkatëse dhe mjetet kërkohen nga organi përkatës i BE-së, shfrytëzuesi i buxhetit duhet të sigurojë mjete nga plani i tij financiar ose nga plani financiar i shfrytëzuesit të buxhetit amë.

#### Neni 56

### **Detyrimet potenciale nga vendimet gjyqësore**

(1) Shfrytëzuesit e buxhetit e informojnë Avokatinë Shtetërore të Republikës së Maqedonisë së Veriut për kontestet gjyqësore dhe jashtë gjyqësore që mund të kenë pasoja financiare direkte ose indirekte për buxhetin jo më vonë se 15 ditë nga njoftimi me shkrim për kontestin.

(2) Avokatia Shtetërore e Republikës së Maqedonisë së Veriut aktualisht e informon Ministrinë e Financave për të gjitha detyrimet e mundshme të përmendura në paragrafin (1) të këtij neni.

(3) Ministri i Financave e përcakton mënyrën e raportimit, formën dhe përmbajtjen dhe mënyrën e mbajtjes së evidencave të detyrimeve sipas këtij neni.

#### Neni 57

### **Ndryshimi i shfrytëzuesve buxhetorë gjatë vitit fiskal**

(1) Nëse sfera e punës ose kompetenca e shfrytëzuesit të buxhetit ndryshohet ose transferohet te një shfrytëzues tjetër i buxhetit, vëllimi i ndarjeve buxhetore do të rritet dhe zvogëlohet në pajtim me rrethanat, me vendim të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(2) Nëse pas miratimit të buxhetit themelohet shfrytëzues i ri i buxhetit, financimi i tij sigurohet para fillimit të punës.

(3) Nëse shfrytëzuesi i ri i buxhetit ndërmerr disa nga detyrat e një shfrytëzuesi ekzistues të buxhetit, rialokohet edhe vëllimi përkatës i aproprijimeve buxhetore të shfrytëzuesit të buxhetit.

(4) Nëse shfrytëzuesi i ri i buxhetit i ndërmerr detyrat e shfrytëzuesit të buxhetit të shuar, rialokohen edhe alokimet përkatëse të buxhetit dhe ndërmerren mjetet dhe detyrimet e mbetura të shfrytëzuesit të buxhetit të shuar.

(5) Nëse shfrytëzuesi i ri i buxhetit ka një vëllim të ri pune dhe autorizime, propozohet dhe miratohet ndryshimi dhe plotësimi i buxhetit.

(6) Nëse shfrytëzuesi buxhetor shuhet gjatë vitit dhe nëse detyrat e tij nuk ndërmerren nga shfrytëzues tjetër buxhetor, aproprijimet për të cilat ai nuk ka ndërmarrë detyrime do të transferohen në rezervën e përgjithshme të buxhetit dhe të gjitha fondet për të cilat ai nuk ka ndërmarrë detyrime, e janë transferuar nga vitet e mëparshme duhet të transferohen në rezervën e përgjithshme të buxhetit. Mjetet e tjera dhe detyrimet e shfrytëzuesit të buxhetit që është shuar, i ndërmerr shfrytëzues tjetër i buxhetit i cili doemos duhet të definohet në aktin e shuarjes.

(7) Nëse pas miratimit të buxhetit themelohet, shuhet ose ndryshohet kompetenca e shfrytëzuesit buxhetor në kuadër të komunës, vëllimi i ndarjeve buxhetore do të rritet dhe zvogëlohet në mënyrë adekuate, me vendim të Këshillit Komunal.

## **VII.6. Rezervat e buxhetit**

### **Neni 58**

#### **Rezerva e përhershme e buxhetit**

(1) Në buxhet sigurohen mjete për rezervë të përhershme të buxhetit. Rezerva e përhershme e buxhetit është një llogari e veçantë brenda sistemit të ETC.

(2) Rezerva e përhershme e buxhetit përdoret për mënjanimin e pasojave të fatkeqësive natyrore, gjendjes së jashtëzakonshme dhe/ose të krizës, pandemive, epidemive dhe fatkeqësive ekologjike.

(3) Mjetet në llogarinë e rezervës së përhershme të buxhetit rriten/ grumbullohen çdo muaj pas 1/12 të aproprijimit buxhetor për rezervë të përhershme të buxhetit. Mjetet e përgjithshme vjetore të mbledhura mbi këtë bazë nuk duhet të kalojnë 1% të të ardhurave të planifikuara nga Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin aktual dhe janë planifikuar brenda planit financiar të Ministrisë së Financave.

(4) Qeveria vendos për shfrytëzimin e rezervës së përhershme të buxhetit në Buxhetit e shtetit.

(5) Pagesat nga rezervat e përhershme të buxhetit mund të bëhen deri në nivelin e mjeteve të disponueshme në llogari të rezervës së buxhetit të përhershëm. Nëse detyrimet për pagesa nga rezerva e përhershme e buxhetit tejkalojnë nivelin e mjeteve të disponueshme në llogari, mjetet do të sigurohen nga aproprijimi buxhetor për rezervën e përhershme të buxhetit, si përjashtim sipas paragrafit (3) të këtij neni, brenda buxhetit në fuqi.

(6) Në fund të vitit rrjedhës, të gjitha mjetet e pashfrytëzuara të llogarisë të rezervës së përhershme barten në vitin në vijim.

(7) Në buxhetin e komunës planifikohen mjete për rezerva të përhershme buxhetore dhe rriten/kumulohen në muaj për 1/12 të aproprijimit buxhetor për rezervë të përhershme buxhetore.

(8) Këshilli i komunës vendos për shfrytëzimin e rezervës së përhershme buxhetore të Buxhetit të komunës.

### **Neni 59**

#### **Rezerva e përgjithshme buxhetore**

(1) Në buxhet planifikohen edhe posaçërisht tregohen mjete për rezerva të përgjithshme buxhetore.

(2) Mjetet nga rezerva e përgjithshme buxhetore shfrytëzohen për raste të parapara për të cilët në buxhetin nuk janë planifikuar mjete ose mjete të lejuara janë të pamjaftueshme. Rezerva e përgjithshme buxhetore në rast të ekzistimit të gjendjes së jashtëzakonshme dhe/ose të krizës, mund të rritet me rishpërndarje të mjeteve ndërmjet shfrytëzuesve amë të buxhetit, për të cilin vendos Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, por zvogëlimi mund të jetë më së shumti deri 5% të mjeteve buxhetore ekzistuese të shfrytëzuesve amë buxhetorë dhe në të njëjtën kohë të mos cenohet funksionimi i rregullt i tyre dhe ushtrimi i kompetencave të përcaktuara ligjore.

(3) Rezerva e përgjithshme buxhetore nuk mund të tejkaloj 3% nga të ardhurat e planifikuara nga Pasqyra për të ardhura dhe shpenzime për vitin rrjedhës dhe planifikohet në kuadër të planit financiar të Ministrisë së Financave.

(4) Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut vendos për shfrytëzimin e rezervës së përgjithshme buxhetore në propozim të shfrytëzuesit amë buxhetor, i përgatitur në bazë të kërkesës nga shfrytëzuesi buxhetor. Mjetet e lejuara shpërndahen nga rezerva e përgjithshme buxhetore në projekt adekuat ose aktivitet nga plani financiar të shfrytëzuesit buxhetor.

(5) Në buxhetin e komunës planifikohen mjete për rezervë të përgjithshme buxhetore.

(6) Këshilli i komunës vendos për shfrytëzimin e rezervës së përgjithshme buxhetore të Buxhetit të Komunës.

## **VII.7. Ndërprerja e përkohshme ose kufizimi i realizimit të buxhetit dhe Ndryshimi dhe plotësimi i buxhetit**

Neni 60

### **Masat për balancimit e buxhetit**

(1) Nëse gjatë vitit realizimi i të ardhurave shmanget 10% nga plani ose të ardhurat rriten si rezultat i obligimeve të reja në buxhet, ndryshimet në trendet ekonomike, ndryshimi i prioritetëve politike, Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut me propozim të Ministrisë së Financave, me vendim mund të ndërpresë ose kufizojë realizimin e shpenzimeve dhe daljeve tjera (në tekstin e mëtejme: ndërprerja e përkohshme e realizimit të buxhetit) për periudhë prej 45 ditëve.

(2) Masat e përfshira me ndërprerjen e përkohshme ose kufizimin i realizimit të buxhetit përfshijnë dhe:

1.Ndërprerja ose kufizimi i ndërmarrja e obligimeve;

2.Marrja e pajtimit paraprak nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut , me mendim paraprak nga Ministria e Financave, për lidhjen e marrëveshjes nga ana e shfrytëzuesit buxhetor;

3.Ndërprerja ose kufizimi i rishpërndarjes së mjeteve të lejuara.

(3) Masat që i referohen ndërprerjes së përkohshme ose kufizimin e realizimit të buxhetit të njëjtë zbatohen për të gjithë shfrytëzuesit buxhetorë për apropijime të veçanta buxhetore, përveç për Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(4) Nëse Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut në afat prej 30 ditëve nga dita e ndërprerjes së përkohshme ose kufizimit të realizimit të buxhetit se balancimi i buxhetit është e pamundur vetëm me zbatimin e masave, propozon Ndryshim dhe plotësim të buxhetit.

(5) Për Vendimin sipas paragrafit (1) të këtij neni Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut doemos duhet ta njoftojë Kuvendin menjëherë pas miratimit të tij.

(6) Nëse gjatë vitit në buxhet të komunës, realizimi i të ardhurave shmanget 10% nga plani ose të ardhurat ose shpenzimet rriten si rezultat i obligimeve të reja në buxhet, ndryshimet në trendet ekonomike, ndryshimi i prioritetëve politike, Këshilli i komunës me propozim të kryetarit të komunës, me vendim mund të ndërpritet ose kufizohet realizimi i shpenzimeve dhe daljeve tjera (financimi i përkohshëm) për periudhë deri 45 ditë.

(7) Nëse në afat prej 30 ditëve nga dita e ndërprerjes së përkohshme ose kufizimit të realizimit të buxhetit të komunës vlerësohet se balancimi i buxhetit të komunës është i pamundur, propozohet Ndryshimi dhe plotësimi i buxhetit të komunës.

## Neni 61

### **Ndryshimi dhe plotësimi i buxhetit**

(1) Nëse gjatë vitit realizimi i të ardhurave ose shpenzimeve në mënyrë të rëndësishme devijojnë nga plani Ministria e Financave i propozon Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut ndryshime dhe plotësime të buxhetit.

(2) Propozim-ndryshimet dhe plotësimet e buxhetit e ndjekin strukturën e buxhetit të miratuar. Propozim-ndryshimet dhe plotësimet e buxhetit duhet të dorëzohet në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut së paku me këtë dokumentacion:

1. Arsyetim për arsyet për përgatitjen e propozimit ndryshimin dhe plotësimin e buxhetit;
2. Shpjegimi për ndikimin e Ndryshimeve dhe plotësimeve të buxhetit mbi projeksionet afatmesme fiskale të prezantuara në strategjinë fiskale;
3. Arsyetimi i propozim ndryshimit dhe plotësimin të buxhetit përfshinë së paku:
  - a) Buxhet i miratuar i fundit për vitin rrjedhës;
  - b) ndryshimet në buxhetin e fundit për vitin vijues/buxheti i vlefshëm;
  - c) propozim Ndryshime dhe plotësime të buxhetit;
  - ç) ndryshime në elementet e definuara në nenin 31 paragrafi (2) pika 2 të këtij ligji nga buxheti i fundit të miratuar për vitin rrjedhës.

(3) Në procedurën për ndryshimin dhe plotësimin e Buxhetit, plani financiar i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut nuk mund të ndryshohet pa pëlqimin e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut , në pajtim me ligjinin për Kuvendin.

(4) Gjatë kohës së procedurës për miratimin e Propozim-Ndryshimeve dhe plotësimeve të buxhetit, Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut mundet përkohësisht ta ndërpresë ose kufizojë realizimin e buxhetit siç është paraparë në nenin 60 të këtij ligji.

(5) Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut ose Këshilli i komunës i miraton Ndryshimet dhe plotësimet e buxhetit të propozimit të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut ose kryetarit të komunës më së voni deri 15 nëntor në vitin rrjedhës.

(6) Nëse gjatë vitit realizimi i të ardhurave ose shpenzimeve në mënyrë të rëndësishme përjashtohen nga plani Kryetari i Këshillit i propozon ndryshimet dhe plotësimet në buxhetin e komunës.

## Neni 62

### **Realizimi i buxhetit deri në fund të vitit**

(1) Ministri i Financave mundet me udhëzim ta rregullojë mënyrën e realizimit të buxhetit deri në fund të vitit, më së voni deri më 15 nëntor në vitin rrjedhës, i cili përmban së paku:

1. Afate deri kur shfrytëzuesit buxhetorë mund të ndërmarrin obligime të reja;
2. Afate deri kur shfrytëzuesit buxhetorë mund ta parashtrojnë dokumentacion për pagesë;
3. Afate për rishpërndarje.

(2) Me përjashtim të afateve sipas paragrafit (1) të këtij neni, detyrimet e reja ose rishpërndarja e ndarjeve buxhetore do të ndërmerren vetëm me pëlqimin paraprak të Ministrisë së Financave.

(3) Kryetari i komunës mund të përcaktojë mënyrën e realizimit të buxhetit komunal deri në fund të vitit, jo më vonë se 15 nëntor të vitit rrjedhës.



## **VII.8. Pagesat e detyrimeve të krijuara dhe refundimi në buxhet**

### **Neni 63**

#### **Pagesa e detyrimeve të krijuara**

- (1) Shfrytëzuesit e buxhetit mund të bëjnë pagesa vetëm për mallrat e furnizuara tashmë, shërbimet e kryera dhe punët dhe detyrimet e tjera që janë përmbushur tashmë.
- (2) Çdo shpenzim ose dalje nga buxheti duhet të bazohet në dokumentacion e besueshëm të kontabilitetit që vërteton detyrimin e pagesës të bërë.
- (3) Baza ligjore dhe shuma e detyrimit të pagimit të ndodhur rrjedhin nga dokumentacioni i kontabilitetit, i cili duhet të verifikohet dhe konfirmohet para pagesës.
- (4) Pagesa duhet të jetë në përputhje me dokumentet nga të cilat del detyrimi i krijuar për pagesë.
- (5) Pagesat në valutë të huaj bëhen në përputhje me kursin zyrtar devizor të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut në ditën e pagesës.
- (6) Pagesat e bëra regjistrohen në sistemin e librit të thesarit.
- (7) Ministri i Financave më afërsisht e përcakton mënyrën e konfirmimit dhe regjistrimit të faturave hyrëse dhe dokumentacioneve të tjera përkatëse dhe pagesave nga buxheti i shtetit ose buxheti komunal.

### **Neni 64**

#### **Afatet për pagesë**

- (1) Detyrimet e shfrytëzuesit të buxhetit duhet të realizohen në pajtim me afatet e parapara për pagesa të përcaktuara me ligj.
- (2) Periudha e pagesës fillon me ditën e marrjes së faturës ose dokumentit tjetër të përshtatshëm të pagesës, i cili është bazë për pagesën.

### **Neni 65**

#### **Pagesat me avancë**

- (1) Me përjashtim të nenit 63 të këtij ligji, pagesa me avancë janë lejuar në rastet e mëposhtme:
  1. detyrimet kontraktuese të cilat janë praktikë afariste dhe nëse kontrata nuk mund të lidhet ndryshe;
  2. detyrimet kontraktuese për projektet e financuara nga BE, organizatat ndërkombëtare ose institucionet financiare ndërkombëtare;
  3. shpenzime për udhëtime zyrtare;
  4. depozitat e ankandit publik;
  5. avanca për pagesën e procedurave gjyqësore;
  6. nëse është e përcaktuar nga donatori ose kreditori.
- (2) Pagesa me avancë lejohet gjithashtu në rastet e parapara me ligjin për prokurime publik, marrëveshjet ndërkombëtare, traktatet, memorandumet dhe marrëveshjet ndërqeveritare.

## **VII.9. Pëlqim për punësimin dhe pagimin e pagave**

Neni 66

### **Pagesa e rrogave për të punësuarit tek shfrytëzuesit buxhetorë**

(1) Shfrytëzuesit amë të buxhetit para se të paraqesin kërkesat për pagesa për pagesën e pagave, dorëzojnë kërkesa për miratimin e mjeteve për paga për Ministrinë e Financave, e cila përmban numrin e të punësuarve, strukturën sipas kualifikimeve dhe të dhëna të tjera të nevojshme. Kërkesa për miratimin e mjeteve për paga duhet të jetë në pajtim me buxhetin e miratuar nga nën-programet dhe duhet të paraqitet në Ministrinë e Financave dy ditë para datës së pagesës së rrogës.

(2) Shfrytëzuesit e buxhetit përgatisin kërkesë përmbledhëse për miratimin e mjeteve për paga, bazuar në llogaritjet individuale të marra nga shfrytëzuesit e buxhetit nën juridiksionin e tyre, brenda afatit të përcaktuar në paragrafin (1) të këtij neni.

(3) Punëtorët e organit të administratës shtetërore që i kryen punët lidhur me përgatitjen dhe realizimin e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut marrin 30% të pagës bazë, si shtesë e pagës së rregullt për shkak të detyrave specifike të punës dhe përgjegjësisë së veçantë që lind nga vendi i punës .

(4) Dispozitat sipas paragrafit (3) të këtij neni nuk zbatohen për punëtorët të cilët gjatë menaxhimit të mjeteve publike kryejnë kontrolle financiare në pajtim me ligjinin dhe mbikëqyrin kryerjen e punëve inspektuese.

Neni 67

### **Pëlqim për punësim**

(1) Shfrytëzuesit buxhetorë të buxhetit të shtetit, mund të punësojnë punëtorë të rinj dhe të plotësojnë vende të zbrazëta të punës, të punësojnë punëtorë në kohë të caktuar dhe të lidhin marrëveshje për kalimin e punëtorit për punësim të përkohshëm për ushtrimin e punëve të përkohshme, vetëm me kusht, nëse për të janë siguruar mjete në Buxhetin shtetit dhe nëse janë planifikuar në planin për plotësimin e vendeve të punës gjatë vitit fiskal, i cili është i parashtruar gjatë parashtrimit të llogaritjes buxhetore.

Kërkesat për pëlqim për punësim, shfrytëzuesit buxhetor përveç ndërmarrjeve publike, i parashtrojnë nëpërmjet shfrytëzuesve buxhetorë amë.

(2) Ndërmarrjet publike dhe subjektet publike private të themeluara nga pushteti qendror, si dhe shoqëritë tregtare të themeluara nga Republika e Maqedonisë së Veriut përveç trupave të pavarur rregullator me autorizime publike të përcaktuara me ligj, mund të punësojnë punëtorë në kohë të caktuar dhe të lidhin marrëveshje për kalimin e punëtorit për punësime të përkohshme për ushtrimin e punëve të përkohshme, vetëm me kusht, nëse për të janë siguruar mjete në planet financiare për vitin rrjedhës fiskal.

(3) Shfrytëzuesit buxhetorë mjeteve të buxhetit të komunave, mund të punësojnë punëtorë të rinj dhe të plotësojnë vende të zbrazëta të punës, të punësojnë punëtorë në kohë të caktuar dhe të lidhin marrëveshje për lëshimin e punëtorit për punësim të përkohshëm për ushtrimin e punëve të përkohshme, vetëm me kusht, nëse për të janë siguruar mjete në buxhetet e komunave.

(4) Gjatë punësimit të punëtorëve të rinj dhe plotësimin e vendeve të zbrazëta të punës, gjatë punësimit të punëtorëve në kohë të vajtur dhe gjatë lidhjes së kontratave për lëshim të punëtorit për punësim të përkohshëm për ushtrimin e punëve të përkohshme, nga paragrafët (1), (2) dhe (3) të këtij neni do të respektohet parimi i përfaqësimit të drejtë dhe adekuat të pjesëtarëve të bashkësive në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

(5) Ministria e Financave, përkatësisht kryetari i komunës janë të obliguar në afat prej 30 ditë nga dita e pranimit të kërkesës për punësim, me shkrim t'i njoftojnë institucionet nga paragrafët (1), (2) dhe (3) të këtij neni, për mjete të siguruar për punësim.

(6) Për mete të siguruar për punësim të nëpunësve administrativë, Ministria e Financave, përkatësisht kryetari i komunës do të japë njoftim me shkrim pas mendim të dhënë paraprakisht pozitiv nga Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës në aktet e sistematizimit.

(7) Ministri i Financave e përcakton mënyrën e dhënies së pajtimeve për punësim të paraparë me këtë nen.

(8) Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut për pëlqimin për sigurimin e mjeteve financiare për punësim vepron në pajtim me ligjinin për Kuvendin e Republikës së Maqedonisë.

## **VII.10. Procedura për shpërndarje të mjeteve**

Neni 68

### **Shpërndarja e mjeteve të kthyeshme dhe pakthyeshme**

(1) Shteti ose komuna mund të nxitin dhe të përkrahin programe dhe projekte të caktuar me ndarje të mjeteve të kthyeshme për financim me kushte të volitshme dhe/ose mjete të pakthyeshme për persona juridikë dhe fizikë.

(2) Kur shfrytëzuesit buxhetorë ndajnë mjete, këtë e bëjnë nëpërmjet tenderit publik, thirrje publike ose nëpërmjet zgjedhjes së drejtpërdrejtë të pranuesve në rrethana të jashtëzakonshme me pajtim paraprak në Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut /Këshill i komunës.

(3) Dispozitat të këtij neni nuk kanë të bëjnë me procedurat të përcaktuara me ligj tjetër ose nëse mjetet janë ndarë drejtpërdrejtë në bazë të ligjit.

## **VIII. SISTEMI I LLOGARISË SË VETME TË THESARIT**

Neni 69

### **Llogaria e vetme e thesarit dhe Sistem i llogarisë së vetme të thesarit**

(1) Ministria e Financave hap LLVTH në Bankën Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut nëpërmjet të cilës do të bëhen transaksione dhe do të evidentohet arkëtimi i të gjitha të hyrave dhe realizimin i të gjitha daljeve të buxhetit të shtetit, buxheteve të komunave dhe shfrytëzuesve buxhetorë; dhe shfrytëzuesve të tjerë buxhetorë përveç nëse nuk është përcaktuar ndryshe me ligj tjetër.

(2) Ministria e Financave krahas LLVTH mund të hap edhe llogari tjera, duke përfshirë edhe llogari për valuta të huaja në Bankën Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Vetëm në raste të jashtëzakonshme, Ministria e Financave mund të hap llogari te institucion tjetër kreditor ose te dhënës i shërbimeve pagesore për menaxhim e mjeteve të veçanta me para të gatshme për të cilat është e nevojshme realizim operativ dhe përcjellje.

(3) Shfrytëzuesit buxhetor dhe komunat hapin llogari dhe mund të dhurojnë mjete vetëm në Thesar.

(4) LLVTH në Bankën Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe llogaritë të tjera të hapura në Ministrinë e Financave në Bankën Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut ose te institucion tjetër kreditor te dhënës tjetër i shërbimeve pagesore, llogaritë të hapura te Thesari nga ana e komunave, shfrytëzuesit buxhetor dhe subjekte të tjera publike në pajtim me ligjin dhe të gjitha llogaritë dhe nënllogaritë tjera të hapura te Thesari për ushtrimin e transaksioneve, evidentim dhe menaxhim të llogarive publike me para të gatshme në pajtim me këtë ose me ndonjë ligj tjetër e përbëjnë sistemin e LLVTH.

(6) Institucionet kreditore dhe dhënësit të tjerë të shërbimeve pagesore nuk guxojnë të hapin llogari ose të pranojnë depozita nga mjete të shfrytëzuesve buxhetorë, përveç nga Ministria e Financave përkatësisht thesari.

(6) Ministri i Financave miraton udhëzim me të cilin më së afërmi rregullohet hapja dhe mbajtja e llogarive të cilat e përbëjnë sistemin e LLVTH.

## Neni 70

### **Thesari dhe sistemi i LLVTH**

(1) Thesari paraqet njësi organizative në korniza të Ministrisë së Financave e cila menaxhon me sistemin e LLVTH dhe me sistemin e librit kryesor të thesarit dhe ushtron punë të tjera të përcaktuara me ligj.

(2) Sistemi i LLVTH së bashku me librin kryesor të thesarit paraqet bazë organizative dhe informuese për sistem solid, efektiv, efikas dhe transparent për menaxhim të financave publike në pajtim me rregullat të vetme për Buxhetin e Shtetit, buxhetet e komunave dhe të gjithë shfrytëzuesit buxhetor dhe subjektet tjera publike të cilët marrin pjesë në sistemin e LLVTH në pajtim me këtë ligj ose me ligj tjetër.

(3) Thesari i kryen këto punë:

1. Menaxhon me Sistemin e LLVTH i cili i përfshin aktivitetet si në vijim:

- hap, mbyll dhe menaxhon me llogari të thesarit dhe llogari bankare të hapura nga ana e Ministrisë së Financave, të shtetit, komunave, shfrytëzuesve buxhetorë dhe subjekteve tjera publike të cilët e përbëjnë sistemin e LLVTH-së në pajtim me këtë ligj ose me ligj tjetër,

-për shtetin, komunat, shfrytëzuesit buxhetorë dhe subjektet tjera publike kryejnë shërbime pagesore si dhënësi i shërbimeve pagesore në pajtim me këtë ligj dhe ligji me të cilin rregullohen shërbimet pagesore dhe sistemet,

-i shpërndan të hyrat dhe privilegjet tjera në llogari në pranuesve në pajtim me këtë ligj,

-siguron informata për pagesat dhe për kthimin e kompensimeve të obligueshme dhe të hyra të tjera të arkëtuara ose kërkuara nga organet tatimore, doganore dhe organet tjera kompetente dhe i barazojnë të dhënat me organet kompetente në nivel shtetëror dhe komunal,

-ngarkon llogari të thesarit për mjete të cilat janë gabimisht të paguara për shkak të gabimit të dhënësit të shërbimeve pagesore,

-ngarkon llogari të thesarit në bazë të autorizime kontraktuese dhe në rast të korigjimit të gabimit të bërë nga Thesari,

-kryen realizimin e llogarive të shfrytëzuesve buxhetorë dhe të subjekteve tjera publike me llogari në LLVTH në bazë të urdhëresave për përmbarim të lëshuara nga gjykata kompetente dhe pushtete tatimore dhe mban evidencë për urdhëresat për përmbarim,

-i njofton bartësit e llogarive për të gjitha transaksionet pagesore dhe për saldon e llogarive dhe u siguron informata të tjera të përcaktuara me ligj dhe me akte të tjera të miratuara nga ministri i Financave,

-siguron të dhëna dhe informata për të hyra në buxhetin e shtetit dhe të komunave dhe për dalje nga këto buxhete,

-siguron të dhëna të shfrytëzuesve buxhetorë dhe organe kompetente dhe organizata, të nevojshme për qëllime statistike, tatimore dhe analitike në pajtim me ligjin dhe akte tjera të përcaktuara në Ministrinë e Financave,

-menaxhon me likuiditetin e mjeteve në korniza të sistemit të LLVTH,

-mund ta ndërpretë realizimin e pagesës së shfrytëzuesve buxhetor në rast të prishjes së likuiditetit të projektuar,

-jep shërbime tjera të përcaktuara me ligj dhe me akte tjera të përcaktuara nga Ministria e Financave.

2. Menaxhon me sistemin e librit kryesor të thesarit, ndër të tjera duke i përfshirë edhe këto detyra:

-i evidenton buxhetet e miratuara, ndryshimet dhe plotësimet e buxheteve dhe i evidenton të gjitha ndryshime të tjera të lidhura me buxhetet;

-mban evidencë për pagesën e të hyrave të LLVTH në korniza të sistemit të LLVTH dhe bën shpërndarje sipas shfrytëzuesve;

-mban evidencës për lokacionet buxhetore, rialokime, detyrime (duke përfshirë kontrata), verifikime, urdhëresa për pagesë dhe pagesa dhe të dala tjera nga buxhetet ose nga sistemi i LLVTH;

-e përkrah menaxhimin e likuiditetit nëpërmjet gjenerimit të projeksioneve të të hyrave dhe daljeve dhe nëpërmjet përpilimit dhe koordinimit të kuotave dhe planeve mujore të likuiditeti,

-mban evidencë për detyrime të papaguara të shfrytëzuesve buxhetorë,

-përpilon raporte ditore dhe periodike për pagesën e të hyrave dhe për realizimin e të dalave të buxhetit të shtetit dhe buxheteve të komunave në pajtim me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare dhe në pajtim me këtë ligj.

(4) Ministri i Financave më së afërmi e përcakton mënyrën e punës së arkës.

Neni 71

### **Menaxhimi i likuiditetit të sistemit të LLVTH**

(1) Ministria e Financave menaxhon me likuiditetin e sistemit të LLVTH, përkatësisht pjesëmarrësit e tij në korniza dhe jashtë nga sistemi i LLVTH.

(2) Jashtë nga sistemi i i LLVTH; Ministria e Financave mund të investojë depozita afatshkurtra në Bankën Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut, bankat komerciale ose kursimoret me seli në Republikën e Maqedonisë së Veriut të cilat kanë leje për dhënie të shërbimi bankar në vend, të japë hua afatshkurtra ose të blejë instrumente financiare në tregun e parave, e gjithë kjo në pajtim me parimet e sigurisë, likuiditetit dhe rentabilitetit.

(3) Në rast të mungesës së mjeteve në para në sistemin e LLVTH, Ministria e Financave tërheq mjete nga huat afatshkurtra ose jep letra afatshkurtra me vlerë dhe instrumente tjera për financim.

(4) Në korniza të sistemit të LLVTH, Ministria e Financave mund të pranojë depozita ose të japë hua afatshkurtra në buxhetin e shtetit, në buxhetet e komunave dhe të subjekteve të tjerë publik të cilit marrin pjesë në sistemin e LLVTH-së me kushte të përcaktuara me ligj dhe rregulla më afër të përcaktuara nga ministri i Financave.

(5) Ministria e Financave mban evidencë të detajuar për punët e menaxhimit të likuiditetit në korniza dhe jashtë sistemit të LLVTH dhe përpilon raport të veçantë financiar që është shtojcë në Llogarinë përfundimtare të Buxhetit.

(6) Ministri i Financave më së afërmi e përcakton mënyrën e menaxhimit të likuiditetit të sistemit të LLVTH.

## **IX. MENAXHIMI I MJETEVE TË SHTETIT DHE TË KOMUNAVE**

### **IX.1. Dispozitat e përgjithshme**

Neni 72

#### **Mjete të shtetit dhe të komunave**

(1) Mjetet financiare dhe jofinanciare (materiale) të shtetit dhe komunat në kuptim të këtij ligj nënkuptojnë mjete të cilat janë në pronë të shtetit dhe komunave.

(2) Mjete financiare janë mjete në para dhe depozita, kërkesa për kredi të dhëna, kërkesa për garanci të paguara, kërkesa të tjera, letra me vlerë dhe aksione kreditore, derivate financiare, tituj dhe pronë tjetër të personave juridikë.

(3) Mjetet jofinanciare paraqesin mjete bazë, teprica, sende me vlerë dhe tokë, pasur natyrore dhe mjete tjera të paprodhuara.

#### Neni 73

### **E drejtë e menaxhimit dhe disponimit të mjeteve**

(1) Me mjetet financiare dhe jofinanciare të administratës shtetërore Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut ose subjektet publike në pronë të shtetit, nëse ajo është përcaktuar me ligj, ndërsa i tjetëron Qeveria, nëse me ligj tjetër nuk është përcaktuar ndryshe.

(2) Me mjetet financiare dhe jofinanciare të komunës menaxhon kryetari i komunës ose subjekt publik i komunës, ndërsa i tjetëron komuna me vendim të Këshillit të komunës, nëse me ligj tjetër më ndryshe nuk është përcaktuar.

(3) Subjektet publike menaxhojnë me mjetet të cilat i shfrytëzojnë përkatësisht posedojnë. Udhëheqësi i subjektit publik është i obliguar të kujdeset, menaxhon dhe mbanë evidencës për mjetet, të cilat i shfrytëzojnë edhe mjetet të cilit janë në pronë të subjektit publik.

(4) Ministria e Financave mban regjistër me të dhëna për mjetet financiare të shtetit dhe në nivel lokal dhe menaxhon me mjetet financiare të shtetit në pajtim me këtë ose ligj tjetër.

(5) Ministri i Financave e përcakton formën dhe përmbajtjen e regjistrit me mjetet financiare të shtetit dhe të komunave.

#### Neni 74

### **Kufizimi për fitimin e mjeteve**

(1) Subjektet publike, përveç ndërmarrjeve publike, nuk kanë pronësi as pajisen me pronësi të mjeteve jofinanciare, përveç nëse me ligj tjetër nuk është paraparë ndryshe.

(2) Subjektet publike nuk guxojnë të marrin pjesëmarrje në kapital, titull ose pjesë tjetër kapitale në korporata të tjera publike ose shoqëri private tregtare pa pëlqim të Qeverisë e Republikës së Maqedonisë së Veriut ose Këshillit të komunës.

(3) Nëse subjekti publik, përveç ndërmarrjeve publike, pajiset me mjete jofinanciare në bazë të dhuratës, trashëgimi ose në mënyrë tjetër, menjëherë doemos duhet të veprojnë ndaj aktiviteteve për bartje të pronësisë të mjeteve të themeluesit të tij, të shtetit ose komunës, përveç nëse me ligj tjetër më ndryshe nuk është përcaktuar.

## **IX.2. Menaxhimi i mjeteve jofinanciare**

#### Neni 75

### **Programi vjetor për shitjen e mjeteve jofinanciare**

(1) Menaxhimi i mjeteve jofinanciare nënkupton shfrytëzimin e mjeteve, mirëmbajtjen e tyre, shitjen dhe qiramarrjen.

(2) Programin vjetor për shitjen e mjeteve jofinanciare e miraton Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut në propozim të Ministrisë së Financave e përpiluar në bashkëpunim me shfrytëzuesit buxhetorë amë.

(3) Në programin për shitjen e mjeteve jofinanciare përfshihen të gjithë mjetet jofinanciare me periudhë të amortizimit më të gjatë se pesë vjet dhe vlerë e vlerësuar mbi 6.000.000 denarë.

(4) Mjetet nga shitja dhe qiramarrja e mjeteve jofinanciare konsiderohet e hyrë buxhetore e shtetit, përveç nëse nuk është ndryshe e përcaktuar në ligj të veçantë.

(5) Në kornizat të Propozimllogarisë përfundimtare të Buxhetit, Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut e njofton Kuvendine Republikës së Maqedonisë së Veriut për realizimin e programit vjetor për shitjen e mjeteve jofinanciare.

(6) Programin vjetor për shitjen e mjeteve jofinanciare të komunës e miraton Këshilli në propozim të kryetarit të komunës.

#### Neni 76

### **Njoftimi për marrëveshje në bazë të koncesioneve dhe partneritetit publik privat**

(1) Shfrytëzuesi buxhetor amë duhet të mbajë regjistër të të gjitha kontratave për koncesione dhe partneritete publik private për të gjithë shfrytëzuesit buxhetor dhe subjektet të tjerë publikë në pjesën e kompetencës së tyre.

(2) Regjistri i shumës së të gjitha kontratave për koncesione sipas paragrafit (1) të këtij neni mbahet në Ministrinë e Financave.

(3) Shfrytëzuesit buxhetor amë rregullisht i dorëzojnë te Ministria e Financave të gjitha dokumentet e nevojshme për kontratat për koncesion në kompetencë të tyre.

(4) Regjistri i shumës të të gjitha kontratave për partneritete publike private sipas paragrafit (1) të këtij neni mbahet në Ministrinë e Ekonomisë.

(5) Ministria e Ekonomisë rregullisht i dorëzon të gjitha të dhënat e nevojshme për kontratat për partneritete publike private te Ministria e Financave.

(6) Ministri i Financave më së afërmi e përcakton formën dhe përmbajtjen e regjistrit të kontratave për koncesione.

### **IX.3. Menaxhimi i mjeteve financiare**

#### Neni 77

### **Investim/blerje të aksioneve, titujve dhe investime tjera në person juridik**

(1) Investimi i personi juridik mund të jetë i drejtpërdrejtë ose indirekt.

(2) Investim i drejtpërdrejtë është investim nga shteti ose komuna në person të caktuar juridik.

(3) Investim indirekt është nga ana e shtetit ose komunës është investim kur ndërmarrje publike ose shoqëri tjetër tregtare në të cilin shteti ose komuna ka investim të drejtpërdrejtë, investon në person tjetër juridik.

#### Neni 78

### **Regjistri i aksioneve dhe titujve**

(1) Ministria e Financave mban regjistër të aksioneve, titujve dhe pjesëmarrje në kapital në persona juridikë të shtetit dhe të komunave.

(2) Për nevojat e regjistrit, ministri i Financave e përcakton mënyrën dhe afatet për dorëzimin e informatave të cilat sigurohen nga:

1. komunat, shfrytëzuesit të tjerë buxhetor dhe subjekte të tjerë publike të cilët menaxhojnë me mjetet financiare të shtetit dhe komunat;

2. personat juridik të në cilët shtetit ose komunat kanë investim të drejtpërdrejtë ose indirekt në kapital;

3. persona të tjerë juridikë sipas paragrafit (3) të këtij neni.

(3) Me qëllim përgatitjen dhe zbatimin e rregullave dhe sigurimin e njoftimit periodik të institucioneve ndërkombëtare financiare dhe organizata, Ministria e Financave ka të drejtë t'i marrë informatat adekuate, duke përfshirë edhe të drejtë të qasjes të përhershme falas të dhënat nga:

- Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe regjistra të tjerë të cilët i udhëheqin organet e autorizuar shtetëror,
- Depozitari qendror për letra me vlerë,
- subjekte të tjera publike të cilët kanë të dhëna për investimet.

Neni 79

### **Menaxhimi i subjekteve publike të cilët nuk janë shfrytëzues buxhetorë**

(1) Ministrinë kompetente dhe kryetarët e komunave, nëse me ligj tjetër nuk është përcaktuar ndryshe, i realizojnë këto detyra:

1. I koordinonin programet për punë dhe planet financiar të subjekteve publik të cilit nuk janë shfrytëzues buxhetor;

2. Ushtron mbikëqyrje në punën, zbatimin e programeve të lejuara dhe planin financiar dhe ngarkimin e këtyre subjekte publik.

3. Ka përfaqësues në bordet drejtuese ose organet e mbikëqyrjes të këtyre subjekteve publike.

(2) Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut ose Këshilli i komunës në propozim të ministrit kompetent ose kryetarit të komunës japin pëlqim të programit për punë (operative dhe investuese), planin vjetor financiar, raportet vjetore financiare dhe raportin për punën e subjekteve publike të cilat nuk janë shfrytëzues buxhetorë.

(3) Të gjitha subjektet publike të cilat nuk janë shfrytëzues buxhetor të Ministrisë së Financave i paraqesin:

- plane vjetor financiar dhe afarist,
- raporte tremujore vjetore,
- raporte financiar vjetor dhe raporte afariste,
- të gjitha të dhënat tjera financiare dhe informata të cilat do t'i kërkojë Ministria e Financave.

(4) Ministri i Financave e përcakton mënyrën, formën dhe afatet për parashtrimin e planeve financiare dhe afariste, raporte, deklarata dhe informata të tjera të theksuara në paragrafin (3) të këtij neni.

Neni 80

### **Themelimi dhe shuarja e subjekteve publike të cilët nuk janë shfrytëzues buxhetorë dhe fitimi dhe shitja e titujve dhe aksioneve në persona juridikë**

(1) Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Këshilli i komunës në propozim të ministrisë kompetente ose kryetarit të komunës miratojnë vendim për themelimin ose shuarjen e subjekteve publike që nuk janë shfrytëzues buxhetor, përveç nëse me ligj tjetër më ndryshe nuk është përcaktuar.

(2) Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut ose Këshilli i komunës në propozim të ministrisë kompetente ose kryetarit të komunës vendos për fitimin e aksioneve ose titujve në persona juridikë, nëse me planin financiar janë planifikuar mjete për këtë dedikim dhe nëse ajo është në dobi të interesi kombëtar ose lokal.



(3) Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut ose Këshilli i komunës në propozim të ministrisë kompetente ose Ministrisë së Financave ose kryetarit të komunës vendos për shitjen e aksioneve ose titujve në persona juridikë nëse interesat kombëtarë ose lokalë tashmë nuk ekzistojnë.

(4) Para blerjes ose shitjes së aksioneve ose titujve ose pjesëmarrje tjetër më kapitalin e personit juridik, ministria kompetente ose kryetari i komunës parashtron propozim për shqyrtim te Ministria e Financave.

(5) Ministria e Financave e shqyrton propozimin sipas paragrafit (4) të këtij neni dhe ministrisë kompetente përkatësisht kryetarit të komunës i jep mendim.

#### Neni 81

### **Arkëtimi i kërkesave nga garancia e aktivizuar**

(1) Në kushte kur është aktivuar garancia nga buxheti i shtetit ose komunat krijohen kërkesa ndaj detyruesit kryesor dhe menjëherë ngihet procedurë për pagesë të kërkesës, nëse më ndryshe nuk është rregulluar me Ligjin për borxh publik.

(2) Bartës i kërkesës nga garancia aktive është Ministria e Financave, kur garancia është aktivizuar nga buxheti shtetëror.

(3) Bartës i kërkesës nga garancia aktive është komuna, kur garancia është aktivizuar nga buxheti i komunës.

#### Neni 82

### **Fitimi i pjesëmarrjes në kapital në persona juridikë me depozitë jomonetare**

Shteti ose komuna mund të pajisen me pjesëmarrje në kapital te persona juridik me depozitë jomonetare edhe atë:

1. konversion të pagesës së tatimeve, kontributeve, përveç kontributet për sigurim të obligueshëm social, ose të dhëna tjera të detyruesit nda shtetit ose komunës të cilat dalin nga procedurat për pagesë falas ose procedura për barazim me forcë në pajtim me ligjin për falimentim;

2. konversioni i kërkesave të cilat dalin nga hua të dhëna dhe garanci të aktivizuara;

3. kontribut me pronë të patundshme dhe të tundshme, përveç pronë e patundshme e cila shfrytëzohet për dhënien e shërbimeve publike.

#### Neni 83

### **Shitja ose konversioni i kërkesave**

(1) Shfrytëzues buxhetor - bartës i kërkesës, përveç kërkesa të cilat dalin nga kontribute të paguara për sigurim të obligueshëm social, nga subjektet të cilit nuk janë subjekte të pushtetit të përgjithshëm nëpërmjet shfrytëzuesit buxhetorë amë mund të propozojë shitje ose konversion të kërkesës, nëse ato janë ekonomikisht të arsyeshme.

(2) Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut ose Këshilli i komunës formon komisioni, i cili jep mendim të arsyetuar për pranimin ose refuzimin e propozimit për shitjen ose konversionin e kërkesave.

(3) Komisioni është i përbërë pse më së paku një përfaqësues i autorizuar nga bartësi i kërkesës, shfrytëzuesi buxhetorë amë, ministria e financave, Ministria e Ekonomisë dhe Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, kur shitet shitja ose konversioni i kërkesë të shtetit dhe

nga më së paku nga një përfaqësues i autorizuar nga bartësi i kërkesës, shfrytëzuesi buxhetor amë, komuna dhe BNJVL, kur propozohet shitje ose konversion të kërkesë të komunës ose më shumë komuna së bashku dhe mund të numërojnë më së shumti 15 anëtarë me atë që numri i anëtarëve kurdoherë është tek.

(4) Me propozim të komisionit vendos me shumicë të numrit të përgjithshëm të anëtarëve, ndërsa për punën e komisionit të anëtarëve u takon kompensim i cili do të paguhet nga llogaria e bartësit të kërkesës.

(5) Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, në propozim të Ministrisë së Financave do të miratojë udhëzim për përbërjen dhe rregulloren e komisionit.

(6) Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut vendos për shitjen ose konversionin e kërkesave të shtetit, ndërsa Këshilli i komunës vendos për shitjen ose konversionin e kërkesave të komunave.

#### Neni 84

### **Prolongimi dhe pagesa e huas në këste ndaj shtetit dhe/ose komunës**

(1) Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut mund me kërkesë të debitorit, ndërsa në propozim të ministrit kompetent me Vendim ta prolongojë pagesën e huas ose të lejojë pagesë në këste, nëse aktiviteti i tillë dukshëm e përmirëson për pagesën e huas të detyruesit, nga i cili ndryshe nuk do të jetë e mundur të paguhet e gjithë huaja në procedurë përmbaruese, falimentuese ose të likuidimit.

(2) Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, në propozim të Ministrisë së Financave, me atë e rregullon lloji e huas, vëllimin dhe procedurën për prolongimin e pagesës, pagesë në këste, e cila del sipas paragrafit (1) të këtij neni për shtetin dhe/ose komunat ndërmjet tyre.

(3) Vlera e kërkesave të çdo bartësi i kërkesë përshkruhet nga evidenca kontabiliste në bazë të vendimi të plotfuqishëm gjyqësor për procedurë të përfunduar të falimentimit ose likuidimit ose ligj tjetër.

(4) Për qëllimet e këtij neni, borxhet ndaj shtetit dhe/ose komunat të cilat dalin nga kontribute të obligueshme për sigurim social nuk konsiderohen si borxh.

(5) Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, ministria kompetente dhe komuna janë të obliguar publikisht t'i shpallin të dhënat për lartësinë e huas dhe debitorët për të cilin është lejuar pagesë e prolonguar e huas dhe kthim në këste.

#### Neni 85

### **Programi vjetor për shitje dhe/ose konversion të mjeteve financiare**

(1) Programin vjetor për shitje dhe/ose konversion të mjeteve financiare e miraton Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut në propozim të Ministrisë së Financave e përpiluar në bashkëpunim me shfrytëzues buxhetor amë të cilit menaxhojnë me mjete financiare.

(2) Në programin për shitje dhe/ose konversion të mjeteve financiare përfshihen aksione dhe tituj të të njëjtit lloj në një subjekt juridik dhe/ose kërkesa nga subjekt i njëjtë juridik me vlerë të konstatuar mbi 3.000.000 denarë, përveç informata sensitive (çmime) të tregut.

(3) Në kornizat të Propozimillogarisë përfundimtare të buxhetit, Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut e njofton Kuvendin për realizimin e programit vjetor për shitjen dhe/ose konversionin e mjeteve financiare.

(4) Programin vjetor për shitjen dhe/ose konversionin e mjeteve jofinanciare të komunës e miraton Këshilli në propozim të kryetarit të komunes.

#### **IX.4. Shitja e mjeteve shtetërore dhe komunale financiare dhe jofinanciare**

Neni 86

##### **Programe individuale për shitje**

Me propozim të shfrytëzuesit kompetent buxhetor amë pas përjashtimi sipas nenit 75 paragrafi (3) dhe neni 85 paragrafi (2) për zbatimin e procedurës për shitje të mjeteve vendos Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut ose Këshilli i komunës me miratimin e programeve individuale për shitje.

Neni 87

##### **Mënyra e shitjes së mjeteve**

Për zbatimin e shitjes së mjeteve individuale financiare ose jofinanciare, përgjegjës është shfrytëzuesi buxhetor i cili menaxhon me mjetet. Udhëheqësi i shfrytëzuesit kompetent buxhetor ose kryetari i komunës emëron komisionin për zbatimin e mbikëqyrjes të procedurës për shitjen e mjete.

#### **X. HUAMARRJA DHE GARANCIA**

Neni 88

##### **Menaxhimi i borxhit publik, procedura për hua marrje dhe lëshimi i garancive**

(1) Menaxhimi i borxhit publik, procedura dhe mënyra e huamarrjes, procedura e lëshimit, servisimit dhe ndërprerjes së garancive shtetërore, si dhe informimi i borxhit publik është i rregulluar me Ligjin për borxh publik.

(2) Ministria e Financave, në emër të shtetit menaxhon me borxhin e pushtetit të përgjithshëm dhe ka të drejtë të kryejë pagesë të parakohshme të borxhit para datës së maturimit dhe blerjes ose zëvendësimit të letrave me vlerë të lëshuara nga shteti, nëse me këtë sigurohet:

1. zvogëlimi i harxhimeve për servisimin e borxhit publik ose
2. përmirësimin e strukturës së afatit të valutës ose kamatës së borxhit të pushtetit të përgjithshëm me qëllim të zvogëlimit të ekspozimit në më së paku një nga këto rreziqe:
  - rreziku i rirfinancimit të borxhit,
  - rreziqet e tregut,
  - rreziqet makroekonomike.

(3) Në kushte të financimit të përkohshëm, Ministria e Financave në emër të shtetit mund ta ngarkohet me borxh deri në shumën e nevojshme për rirfinancim të obligimeve për krye gjënë dhe kamatat në bazë të borxhit të pushtetit të përgjithshëm në vitin fiskal rrjedhës.

(4) Ministria e Financave në emër të shtetit ë vitin fiskal rrjedhës, si dhe gjatë kohës së financimit të përkohshëm, mundet në mënyrë plotësuese të ngarkohet me borxh për financimin e likuiditetit të ndërlidhur me rrjedhat e parave në dorë, në ç'rast saldo e ngarkimit me borxh të bazë ditore nuk mund të tejkalojë 5% nga shpenzimet e plota të përcaktuara me buxhetin e fundit të miratuar.

(5) Për realizimin e buxheteve të komunave në vitin fiskal rrjedhës, komuna mund të marrë borxh nga Buxheti i shtetit, ose me lidhjen e marrëveshjes për borxh me banka ose lëshimin e letrave debitore me vlerë në vend ose në vende të huaja.

(6) Komuna detyrimisht duhet para çdo ngarkimi me borxh të marrë pëlqim nga Ministria e Financave në pajtim me procedurën e përcaktuar me Ligjin për borxh publik dhe Ligjin për financimin e njësive të vetëqeverisjes lokale.

(7) Në emër të shtetit, Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut mund të lëshojë garanci gjatë ngarkimit të borxh të bartësve të borxhit publik të definuar në Ligjin për borxh publik. Komunat mund të lëshojnë garanci gjatë ngarkimit me borxh të ndërmarrjeve dhe shoqërive tregtare ku kanë ndikim direkt ose indirekt me miratimin e vendimit të Këshillit të komunës. Nëse ndërmarrja publike ose shoqëria tregtare është në pronësi të dy ose më shumë komunave mund të lidhë marrëveshje multilaterale për garanci. Forma të ndryshme të shtetit ose komunave nuk janë të lejuara.

(8) Transaksionet e lidhura në kundërshtim me paragrafin (7) të këtij neni janë të asgjësuara.

(9) Të gjitha subjektet publike, përpos të cekurat në paragrafin (6) të këtij neni, nuk guxojnë të lëshojnë garanci.

(10) Për realizimin e Buxhetit të Shtetit në vitin fiskal rrjedhës, Ministria e Financave në emër të shtetit mund të marrë hua brenda dhe jashtë vendit deri në shumën e:

1. shumën e deficitit të përcaktuar në Pasqyrën e të hyrave dhe shpenzimeve dhe shumën e reduktimit neto të përcaktuar në Pasqyrën e mjeteve dhe detyrimeve financiare, dhe

2. shumën e kërkuar për rifinancimin e detyrimeve të pagesës së kryegjësë në vitin fiskal rrjedhës dhe për dy vitet e ardhshme fiskale të përcaktuara nga strategjia fiskale e fundit e miratuar.

(11) Shumat maksimale të huamarrjes sipas paragrafit (10), pika 1 dhe 2 janë të përcaktuara me Ligjin për realizimin e buxhetit.

#### Neni 89

### **Marrja e borxhit**

(1) Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, mund të marrë borxhe në bazë të huazimit dhe letrave me vlerë nga subjektet publike.

(2) Ministri i Financave, në emër të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut nënshkruan Marrëveshje për marrjen e borxhit, pas miratimit të ligjit të veçantë për marrje të borxhit.

(3) Propozim-ligjin në bazë të të cilit Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut do ta marrë në bazë të huave dhe letrave me vlerë nga subjektet publike borxhin vitin e ardhshëm fiskal dorëzohet në Kuvend më së voni deri më 1 tetor të vitit fiskal rrjedhës.

(4) Shfrytëzuesit buxhetorë dhe komunat nuk mund të marrë borxhin e përcaktuar me këtë ligj.

#### Neni 90

### **Lizingu fiskal**

(1) Me propozim të shfrytëzuesit buxhetor ose të Kryetarit të Komunës, Ministri i Financave, jep leje për propozimet për përfshirjen e marrëveshjeve për lizingu fiskal të shfrytëzuesve buxhetorë të buxhetit të shtetit, ose të komunës.

(2) Shfrytëzuesi buxhetor nuk mund të fillojë procedurë për lidhjen e marrëveshjes për lizingu fiskal para marrjes së lejes nga Ministria e Financave.

(3) Ministri i Financave më hollësisht e përcakton mënyrën e lëshimit të lejes për propozimet për lidhjen e marrëveshjeve për lizing fiskal të shfrytëzuesve buxhetorë të buxhetit të shtetit, ose të komunës.

## XI. NJOFTIMI DHE TRANSPARENCA

### Neni 91

#### **Njoftimi për realizimin e buxhetit**

(1) Ministria e Financave shpall në veçanti:

1. raport mujor për realizimin e buxhetit të shtetit;
2. raport tremujor të përmbledhjes për realizimin e buxhetit të komunave;
3. raport tremujor të konsoliduar për realizimin e buxhetit të shtetit dhe komunave.

(2) Raportet publikohen në ueb-faqen e Ministrisë së Financave në afat prej një muaji nga fundi i muajit/tremujorit.

(3) Kryetari i Komunës në ueb-faqen e komunës shpall raport mujor për realizimin e Buxhetit të komunës në afat prej një muaji nga fundi i muajit/tremujorit.

(4) Ministria i Financave e përcakton formën dhe përmbajtjen e raporteve për publikim.

### Neni 92

#### **Raporti gjysmëvjetor për realizimin e buxhetit**

(1) Ministri i Financave ose kryetari i komunës dorëzojnë raport në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut ose në Këshillin e Komunës për realizimin e buxhetit për pjesën e parë të vitit më së voni deri më 31 korrik në vitin rrjedhës.

(2) Raportet duhet të përmbajnë:

1. Të dhëna për lëvizjet makroekonomike;
2. Raportet për të hyrat dhe shpenzimet e realizuara në pajtim me strukturën buxhetit të miratuar, bilancit buxhetor, huamarrja dhe realizimi i vlerësuar deri në fund të vitit;
3. Të dhëna për obligimet, shpërndarjen, ndryshime tek shfrytëzuesit buxhetor gjatë vitit, shfrytëzimin e rezervave buxhetore, garanci të lëshuara dhe paguara dhe kërkesa të arkëtuara nga garancitë e lëshuara;
4. Arsyetimi për lëshime më të mëdha se sa të paguarat në raport me buxhetin në fuqi.

(3) Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut është e obliguar që raportin ta dorëzojë në Këshillin fiskal të Kuvendit, më së voni deri më 1 shtator në vitin rrjedhës.

(4) Ministri i Financave më hollësisht e përcakton mënyrën e përgatitjes, formën dhe përmbajtjen e raportit gjysmëvjetor për realizimin e buxhetit të shtetit dhe të komunave.

### Neni 93

#### **Përmbajtja e Llogarisë përfundimtare të buxhetit të shtetit ose të komunës**

(1) Llogaria përfundimtare e buxhetit është akt i shtetit ose komunës me të cilin shfaqet realizimi i buxhetit në shtet ose komunë për vitin paraprak buxhetor.

(2) Llogaria përfundimtare e buxhetit përmban:

1. raport financiar për realizimin e buxhetit;
2. arsyetim të pjesës së përgjithshme të Llogarisë përfundimtare të buxhetit;

3. arsyetim të pjesës së veçantë të Llogarisë përfundimtare të buxhetit, duke përfshirë edhe raportin për qëllimet e arritura dhe rezultatet;

5. arsyetim të të dhënave nga bilanci i gjendjes.

(3) Raportin financiar për realizimin e buxhetit e përcjell struktura dhe përmbajtja e buxhetit. Ky i përfshin të hyrat e planifikuara dhe të realizuara dhe të hyrat nga buxheti i shtetit ose komunës.

(4) Arsyetimi i pjesës së përgjithshme të Llogarisë përfundimtare të buxhetit përmban së paku:

1. indikatorë të projektuar makroekonomik si pikë fillestare në të cilën bazohet buxheti dhe realizimi i tyre gjatë vitit;

2. arsyetim të pjesës së përgjithshme të buxhetit;

3. arsyetim për shpërndarjet gjatë vitit;

4. ndryshim të shfrytëzuesve buxhetorë gjatë vitit në pajtim me nenin 57 të këtij ligji;

5. arsyetim të masave të miratuara për barazimin e buxhetit në pajtim me nenin 60 të këtij ligji;

6. arsyetim për ndryshimet mes buxhetit të miratuar dhe në fuqi në pajtim me nenin 47 të këtij ligji;

7. raport për shfrytëzimin e rezervës ekzistuese buxhetore në pajtim me nenin 58 të këtij ligji;

8. raport për shfrytëzimin e rezervës së përgjithshme në pajtim me nenin 59 të këtij ligji;

9. raport për programin vjetor për shitjen e mjeteve jofinanciare në pajtim me nenin 75 të këtij ligji;

10. raport për programin vjetor për shitjen dhe/ose konversionin e mjeteve financiare në pajtim me nenin 85 të këtij ligji;

11. raport për obligimet e maturuara, të papaguara;

12. raport për huamarrje në tregun kapital vendas dhe të huaj;

13. raport për garanci të lëshuara dhe borxhe të dhëna;

14. raport për ndikimin e shpenzimeve buxhetore mbi hyrjet;

15. raport për realizimin e buxheteve të komunave;

16. të dhëna të tjera të nevojshme.

(5) Arsyetimi i pjesës së veçantë të Llogarisë përfundimtare të buxhetit, e përfshinë edhe raportin e qëllimet e arritura dhe rezultatet, si dhe indikatorët gjinor përgjegjës. Raporti përfshinë vlerësim të suksesit në arritjen e qëllimeve dhe sqarimin për shkaqet e lëshimit nga qëllimet e vendosura.

(6) Llogaria përfundimtare e buxhetit i përfshinë këto anekse:

1. bilance të konsoliduara të gjendjes së shtetit dhe komunave;

2. raportin sipas nenit 71 paragrafi (5) të këtij ligji.

(7) Ministri i Financave për së afërmi e përcakton, mënyrën e përgatitjes, formën dhe përmbajtjen e Llogarisë përfundimtare të buxhetit të shtetit ose buxhetet e komunave, raportet vjetore të konsoliduar për realizimin e planit vjetor për realizimin e planeve financiare të shfrytëzuesve buxhetorë në kompetencë të shfrytëzuesit buxhetor amë dhe raportet vjetore financiare të shfrytëzuesve buxhetorë.

## Neni 94

### **Përgatitja dhe miratimi i propozimllogarisë përfundimtare të Buxhetit të shtetit ose të komunave**

(1) Shfrytëzuesi buxhetor përgatit raporte vjetore financiare dhe shfrytëzuesit kompetent amë i siguron të dhëna për përgatitjen e raportit vjetor të konsoliduar për realizimin e planeve financiare të shfrytëzuesve buxhetorë në kompetencë të tij për vitin paraprak më së voni deri më 1 mars të vitit të ardhshëm.

(2) Shfrytëzuesi buxhetor amë përpilon raport të konsoliduar vjetor për realizimin e planeve financave dhe siguron të dhëna për përgatitjen e Propozimllogarisë përfundimtare të buxhetit për vitin paraprak dhe e dorëzon në Ministrinë e Financave dhe kryetarit të komunës më së voni deri më 15 mars të vitit rrjedhës.

(3) Ministria e Financave Propozimllogarinë përfundimtare të buxhetit të shtetit e dorëzon në Entin Shtetëror të Revizionit dhe në Këshillin Fiskal më së voni deri më 30 prill të vitit rrjedhës.

(4) Kur përpilon draft raport të revizionit, Enti Shtetëror i Revizionit mund të japë rekomandime të revizionit për korrigjimin e parregullsisve. Këto rekomandime për korrigjimin e parregullsisve detyrimisht duhet të bazohen në dispozitat që janë në fuqi dhe detyrimisht duhet të përmbajnë bazë juridike dhe referim në dokumentet autentike të besueshme të kontabilitetit që mundësojnë korrigjimin e parregullsisve të përcaktuar në Entin Shtetëror të Revizionit në propozimin e Raportit financiar për realizimin e buxhetit të shtetit.

(5) Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut vendos dhe i arsyeton aktivitetet që i zbaton për korrigjimin e parregullsisve sipas paragrafit (4) të këtij neni dhe në mënyrë me të cilën në përkatësisht e informon Entin Shtetëror të Revizionit dhe e përcakton mënyrën përfundimtare të Raportit financiar për realizimin e buxhetit të shtetit.

(6) Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriute miraton Propozimllogarinë përfundimtare të buxhetit të shtetit sipas paragrafit (2) të këtij neni së bashku me raportin final të Entit Shtetëror të Revizionit dhe me arsyetim të mospranimit të një pjese të rekomandimeve të revizionit për aktivitetet për korrigjim të parregullsisve e dorëzon në Kuvend më së voni deri më 1 tetor gjatë vitit rrjedhës për miratim.

(7) Gjatë miratimit të Llogarisë përfundimtare të buxhetit të shtetit, Kuvendi i shqyrton vërejtjet e propozuara nga ana e revizorit.

(8) Kryetari i Komunës e përgatit Propozimllogarinë përfundimtare të buxhetit të komunës dhe e dorëzon në Ministrinë e Financave më së voni deri më 31 mars të vitit rrjedhës.

(9) Kryetari i Komunës e dorëzon Propozimllogarinë përfundimtare të buxhetit të komunës deri në Këshillin e komunës për miratim më së voni deri më 30 prill të vitit rrjedhës.

(10) Llogaria përfundimtare e buxhetit të komunës dorëzohet në Ministrinë e Financave dhe në Entin Shtetëror të Revizionit jo më vonë se 15 ditë pas miratimit në Këshillin e komunës.

(11) Me përjashtim sipas paragrafit (10) të këtij neni, nëse Këshilli i komunës nuk e miraton llogarinë përfundimtare të buxhetit të komunës, ai dorëzohet në Ministrinë e Financave dhe në Entin Shtetëror të Revizionit më së voni në afat prej 60 ditësh nga data e dorëzimit në Këshillin e komunës.

(12) Llogaria përfundimtare e buxhetit publikohet në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut, ndërsa Raporti përfundimtar për realizimin e buxhetit në ueb-faqen e Ministrisë së Financave më së voni një muaj nga miratimi i tyre.

(13) Llogaria përfundimtare e buxhetit të komunës shpallet në Fletoren zyrtare të komunës, ndërsa raporti financiar për realizimin e buxhetit të komunës në ueb-faqen e komunës më së voni në afat prej një muaji nga dita e miratimit të tyre.

Neni 95

### **Transparencë në subjekte publike që nuk janë shfrytëzues buxhetor**

(1) Të gjitha ndërmarrjet publike dhe subjektet tjera publike të cilat nuk janë shfrytëzues buxhetor në ueb-faqen e tyre i publikojnë këto dokumente:

- Plani vjetor financiar dhe i buxhetit për vitin rrjedhës,
- Raporti vjetor financiar për vitin paraprak,
- Raportet financiare tremujore dhe gjashtëmujore,

- Raporti tremujor për detyrimet e maturuara dhe të papaguara dhe
- Raport i revizorit dhe raport i organit mbikëqyrës, nëse ekziston.

(2) Dokumentet sipas paragrafit (1) të këtij neni publikohen në afat prej një muaji nga miratimi i tyre nga organi kompetent në subjekt.

Neni 96

### **Publikimi në ueb-faqe**

(1) Shfrytëzuesit buxhetorë në ueb-faqet e tyre i publikojnë së paku:

1. planet e miratuara financiare;
2. raportet tremujore për realizim;
3. raportet vjetore financiare dhe
4. iniciativa buxhetore vjetore gjinore.

(2) Shfrytëzuesit buxhetor amë përpos dokumentet sipas paragrafit (1) të këtij neni në afat prej një muaji pas kalimit të periudhës për të cilën lajmërojnë në ueb-faqet e tyre publikojnë:

1. strukturën organizative të të gjitha subjekteve të shfrytëzuesve buxhetorë dhe subjekteve të tjera në kuadër të kompetencave të tyre, së bashku me linqet në ueb-faqet e tyre;

2. regjistra të të gjitha marrëveshjeve për koncesion dhe partneritet publik privat sipas nenit 76 paragrafi (1) të këtij ligji.

(3) Ministria e Financave në ueb-faqen e vet publikon së paku:

1. buxhetin e miratuar të shtetit me dokumentacionin buxhetor;
2. buxhetin qytetar;
3. raporte për realizimin e Buxhetit të shtetit dhe buxhetet e komunave;
4. raport gjysmë vjetor për realizimin e Buxhetit të shtetit;
5. raport të revizionit nga Enti Shtetëror i Revizionit, në pajtim me nenin 94 paragrafi (6) të këtij ligji.
6. Llogaria përfundimtare e Buxhetit të Shtetit.

(4) Planet, raportet dhe dokumentet tjera të cekura në paragrafët (1), (2) dhe (3) të këtij neni publikohen në afat prej një muaji nga përgatitja ose miratimi i tyre, përpos nëse nuk është ndryshe e përcaktuar me këtë ose me ndonjë ligj tjerët.

## **XII. KONTABILITETI DHE KONSOLIDIMI**

Neni 97

### **Sistemi i kontabilitetit**

Për menaxhimin e kontabilitetit dhe përpilimin e raporteve financiare për buxhetin dhe shfrytëzuesit buxhetor, zbatohen dispozitat e kontabilitetit të buxheteve dhe shfrytëzuesve buxhetorë, vetëm nëse me këtë ligj nuk është ndryshe e përcaktuar.

Neni 98

### **Përgjegjësitë e shërbimit të kontabilitetit**

Shërbimi kompetent për kontabilitetin e buxheteve dhe shfrytëzuesve buxhetorë i siguron dhe proceson të dhënat në bazë të evidencës së kontabilitetit që del nga ngjarjet afariste, mban regjistra afarist, përgatit dokumentacion të pagesave, përpilon raporte të ndryshme, bën mbikëqyrje të kontabilitetit dhe e organizon ruajtjen e dokumenteve origjinale të kontabilitetit, nëse me ligj të veçantë nuk është e rregulluar ndryshe.



Neni 99

**Kontabilist i autorizuar**

(1) Kontabilist i autorizuar është personi i cili i kryen funksionet dhe detyrat e shërbimit të kontabilitetit dhe është përgjegjës për përpilimin e raporteve financiare. Kontabilisti i autorizuar është përgjegjës për përgatitjen e të dhënave për raportin vjetor për realizimin e buxhetit.

(2) Kontabilistin e autorizuar e emëron udhëheqësi i shfrytëzuesit buxhetor. Nëse shfrytëzuesit buxhetor organizojnë shërbim të përbashkët të kontabilitetit, personi përgjegjës për kontabilitet për shfrytëzues të caktuar buxhetor në shërbim të përbashkët për kontabilitet.

(3) Kontabilisti i autorizuar vepron në pajtim me këtë ligj, Ligjin për kontabilitet të buxheteve dhe shfrytëzuesve buxhetorë, Ligjin për realizimin e buxhetit të shtetit përkatësisht Vendimin për realizimin e buxhetit të komunës dhe dispozitave tjera të ndërlidhura. Nëse kontabilisti i autorizuar konsideron se pagesa është në kundërshtim me dispozitat e përmendura më lartë, e ndërpret pagesën dhe e informon në formë të shkruar udhëheqësin e shfrytëzuesit buxhetor. Ndërprerja e pagesës mund të kryhet me kërkesë me shkrim të udhëheqësit.

Neni 100

**Raporte vjetore financiare**

(1) Raportet vjetore financiare të shfrytëzuesve buxhetorë janë bilanci i të hyrave dhe shpenzimeve dhe bilanci i gjendjes.

(2) Shfrytëzuesit buxhetorë janë të obliguar ndaj raporteve vjetore financiare të përgatisin arsyetim që është pjesë përbërëse e raporteve dhe ato janë publikisht të arritshme.

Neni 101

**Dorëzimi i raporteve vjetore financiare**

Shfrytëzuesit buxhetorë i dorëzojnë raportet vjetore financiare sipas nenit 100 paragrafi (1) të këtij ligji në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut deri më 28 shkurt në vitin rrjedhës.

Neni 102

**Konsolidimi**

(1) Shfrytëzuesit buxhetorë amë i konsolidojnë raportet financiare vjetore të shfrytëzuesve buxhetorë që janë në kompetencë të tyre dhe përgatisin raporte vjetore financiare të konsoliduar.

(2) Shfrytëzuesit buxhetorë amë dorëzojnë raporte financiare vjetore të konsoliduara sipas paragrafit (1) të këtij neni në Regjistrin qendror deri më 15 mars në vitin rrjedhës.

(3) Regjistri qendror deri më 31 mars në vitin rrjedhës i dorëzon raportet financiare sipas paragrafit (2) të këtij neni në formë elektronike në Ministrinë e Financave.

Neni 103

**Bilanci i konsoliduar i gjendjes së shtetit dhe komunave**

(1) Ministria e Financave e përgatit bilancin e konsoliduar të gjendjes së shtetit dhe komunave dhe është pjesë përbërëse e Llogarisë Përfundimtare të buxhetit të shtetit.

(2) Ministria e Financave e dorëzon bilancin e konsoliduar të gjendjes sipas paragrafit (1) të këtij neni në Regjistrin Qendror në afat prej 15 ditëve nga miratimi i Llogarisë përfundimtare të buxhetit të shtetit nga ana e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

### XIII. KONTROLLI I BRENDSHËM FINANCIAR NË SEKTORIN PUBLIK

Neni 104

#### **Kontrolli i brendshëm financiar**

(1) Sistemi për kontrollin e brendshëm financiar në sektorin publik e përfshinë menaxhimin financiar dhe kontrollin, revizionin e brendshëm, harmonizimin dhe koordinimin e aktiviteteve për vendosjen dhe zhvillimin e tyre.

(2) Standardet, metodologjia, marrëdhëniet, përgjegjësitë si dhe kompetencat e Ministrisë së Financave dhe organeve të tjera në zbatimin e sistemit të kontrollit të brendshëm financiar në sektorin publik rregullohen me ligj të veçantë.

### XIV. INSPEKSIONI FINANCIAR NË SEKTORIN PUBLIK

Neni 105

#### **Inspekcioni financiar në sektorin publik**

(1) Ministria e Financave e zbaton inspektionin financiar në pajtim me ligjinin.

(2) Qëllimet parimet, kompetenca, organizimi i inspektionit financiar në sektorin publik, si dhe procedura për kryerjen e inspektionit financiar rregullohen me ligj të veçantë.

### XV. SISTEMI I INTEGRUAR INFORMATIV PËR MENAXHIM TË FINANCAVE PUBLIKE

Neni 106

#### **Sistem i integruar informativ për menaxhim e financa publike**

(1) Ministria e Financave vendos sistem të integruar informativ për menaxhim të financave publike.

(2) Komponentët bazë të sistemit të integruar informativ për menaxhim të financave publike janë:

-planifikimi buxhetor (shumëvjeçare, duke përfshirë edhe planifikimin e projekteve kapitale/investimet publike),

- realizimi i buxhetit (duke përfshirë të gjitha shpenzimet të hyrat dhe operacionet ETC);

- evidentimi i nevojave të sistemit të regjistrit kryesor të thesarit dhe informimit,

- menaxhimi i borxhit,

- themelimi dhe menaxhimi i regjistrave të detyrueshëm dhe klasifikime,

- lidhshmëri me sisteme të ndryshme të shkëmbimit automatik të të dhënave në Qeveri të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe në vend,

- depozitimi i të dhënave dhe veglave për informim për përkrahje dhe përcjellje të miratimit të vendimeve,

- ueb portale për sigurimin e qasjes së sigurt të të gjithë shfrytëzuesve buxhetorë të autorizuar dhe subjekteve të tjera të autorizuar dhe

- komponentë të tjera të nevojshme për përkrahjen e zbatimit të Ligjit të Buxheteve dhe për menaxhim të financave publike.

### **Trupi punues për zbatimin e Sistemit të Integruar Informativ për menaxhimin e financave publike**

#### Neni 107

(1) Ministri i Financave formon Trup Punues për zbatimin e Sistemit të Integruar Informativ për Menaxhimin e Financave Publike (në tekstin e mëtejme: Trupi Punues).

(2) Trupi punues është përgjegjës për: zbatimin, përmirësimin, optimizimin, ekzekutimin, rregullimin, mirëmbajtjen, kontrollin, edukimin e stafit dhe analizën e të gjitha proceseve dhe funksionaliteteve që lidhen me sistemin e integruar informativ për financat publike.

(3) Trupi punues përbëhet nga kryetari, zëvendësi, koordinatorët dhe anëtarët nga radhët e punëtorëve të ministrisë, të cilët i emëron Ministri i Financave, me mandat 5 vjeçar.

(4) Me përjashtim të paragrafit 3 të këtij neni, ministri mund të angazhojë persona të tjerë në Trupin punues për kryerjen e zbatimit, përmirësimin, optimizimin, ekzekutimin, rregullimin, mirëmbajtjes, kontrollit, edukimit dhe punëve tjera që kanë të bëjnë me sistemin e integruar informativ për financat publike.

(5) Kriteret për përcaktimin dhe shkarkimin e kryetarit, zëvendësit, koordinatorëve dhe anëtarëve të Trupit punues nga paragrafët 3 dhe 4 të këtij neni, të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e tyre i përcakton Ministri i Financave me akt të veçantë.

(6) Kryetari, zëvendësi, koordinatorët dhe anëtarët e Trupit punues nga paragrafët 3 dhe 4 kanë të drejtë në kompensim të përcaktuar nga Ministri i Financave me akt të veçantë.

(7) Mënyra e punës së Trupit Punues rregullohet më afër me Rregulloren e Punës.

(8) Trupi punues i paraqet raport për punën e tij ministrit të Financave sipas nevojës dhe së paku dy herë në vit.

(9) Ministri i Financave mund të themelojë grupe punuese/komisione ekspertësh për nevojat e trupit punues, për të cilat mund të caktojë kompensim, për shkak të shtrirjes dhe kompleksitetit të punës.

(10) Mjetet për financimin e Trupit punues dhe grupeve/komisioneve punuese të ekspertëve sigurohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

## XVI. MBIKËQYRJA

#### Neni 108

### **Mbikëqyrja**

Mbikëqyrjen mbi zbatimin e dispozitave të këtij ligji e bën Ministria e Financave nëpërmjet inspektionit financiar në sektorin publik, në pajtim me ligjinin për inspektion financiar në sektorin publik.

## XVII. DISPOZITA NDËSHKUESE

#### Neni 109

### **Dispozita ndëshkuese për shfrytëzuesit buxhetorë**

(1) Gjobë me shumë prej 1.000 deri 10.000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit përgjegjës në personin juridik shfrytëzues nëse:

1. gжатë dorëzimit të Propozim-ligjeve dhe rregullave në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nuk dorëzon formular për vlerësim të implikimeve afatmesme fiskale, në pajtim me nenin 8 paragrafin (1) të këtij ligji;
2. gжатë dorëzimit të formularit fiskal sipas nenit 8 i këtij ligji, jo realisht i shfaq implikimet plotësuese fiskale mbi Buxhetin e Republikës së Maqedonisë;
3. nuk i përshtat projektet dhe aktivitetet e shfrytëzuesit buxhetor në pajtim me nenin 42 në afatin e paraparë të paragrafit (2) të nenit të njëjtë;
4. nuk arrin të sigurojë pagesë të plotë dhe në kohë të të hyrave në buxhet në kuadër të kompetencave të veta dhe për shpërndarjen e tyre në buxhet në pajtim me nenin 44 paragrafin (1) dhe (2) të këtij neni;
5. ndërmerr obligime në kundërshtim me nenet 50 dhe 51 të këtij ligji;
6. ndërmerr obligime ose bën pagesa nga buxheti në shumë më të madhe nga rezervimet e mjeteve të ndara në buxhet në kundërshtim me nenin 50 paragrafin (4) të këtij ligji;
7. nuk e informon Avokatinë e Shtetit ose jo në kohë e informon për konteste gjyqësore dhe jashtë gjyqësore të cilat mund të kenë direkt ose indirekt pasoja financiare në buxhet, në pajtim me nenin 56 paragrafi (1) të këtij ligji;
8. ndërmerr obligime të reja ose kryen rishpërndarje të përvetësimeve buxhetore jashtë afatit të përcaktuar në nenin 62 paragrafin (1) të këtij ligji, ose pa leje paraprake të ministrit të Financave në kundërshtim me nenin 62 paragrafin (2) të këtij ligji, ose pa pëlqimin paraprak nga Ministria e Financave në kundërshtim me nenin 62 paragrafi (2) të këtij ligji;
9. bën pagesë në kundërshtim me nenin 63 të këtij ligji;
10. huazon mjete ose lëshon garanci pa i plotësuar kushtet e përcaktuara në nenin 88 të këtij ligji;
11. hap llogari pa pëlqim paraprak nga ministri i Financave (neni 69 dhe 70);
12. nuk dorëzon ose jo nuk kohë i dorëzon te shfrytëzuesi kompetent buxhetor, të dhënat për përgatitjen e raportit vjetor të konsoliduar për realizimin e planeve financiare të shfrytëzuesve buxhetorë në kompetencë të tij në pajtim me nenin 94 paragrafi (1) të këtij ligji;
13. nuk i publikon në ueb-faqen e tij planet e miratuara financiare, raportet tremujore ose raportet vjetore financiare, në pajtim me nenin 96 paragrafi (1) të këtij ligji;
14. nuk i dorëzon ose nuk i dorëzon në kohë raportet financiare në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë, në pajtim me nenin 101 të këtij ligji.

#### Neni 110

### **Dispozitat kundërvajtëse për shfrytëzuesit buxhetorë amë**

- (1) Gjobë me shumë prej 1.000 deri 10.000 euro në kundërvlerë me danarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit përgjegjës në personin juridik - shfrytëzuesit buxhetor amë nëse:
1. nuk përgatit plan strategjik për aktivitetet në kuadër të kompetencave nga institucioni i vet në pajtim me nenin 13 të këtij ligji;
  2. nuk e dorëzon ose nuk e dorëzon në kohë në Ministrinë e Financave skenarin bazë dhe propozimin për iniciativa të reja për financimin e nenit 17 të këtij ligji;
  3. nuk dorëzon ose nuk i dorëzon në kohë në Ministrinë e Financave propozim planet financiare për të gjithë shfrytëzuesit buxhetor në kuadër të kompetencave të veta, në pajtim me nenin 33 paragrafi (1) të këtij ligji;
  4. nuk e dorëzon planin e miratuar financiar në Ministrinë e Financave, në pajtim me nenin 43 paragrafi (2) të këtij ligji;
  5. nuk e përcjellë pagimin e të hyrave dhe të ardhurave të tjera dhe pagesat e bërë në llogarinë e shfrytëzuesve buxhetorë në kuadër të kompetencave të tij, në pajtim me nenin 44 paragrafi (3) të këtij ligji;

6. nuk mban regjistër të koncesioneve dhe partneriteti privat publik, në pajtim me nenin 76 paragrafi (1) të këtij ligji;

7. nuk e dorëzon ose nuk e dorëzon në kohë raportin e konsoliduar vjetor për realizimin e planeve financiare të shfrytëzuesve buxhetorë në kompetencë të tij për Ministrin e Financave përkatësisht për Kryetarin e Komunës në pajtim me nenin 94 paragrafi (2) të këtij ligji;

8. nuk i publikon në ueb-faqen e vet të dhënat e nevojshme në pajtim me nenin 96 paragrafi (1) dhe (2) të këtij ligji;

9. nuk e dorëzon ose nuk e dorëzon në kohë raportet e konsoliduara vjetore në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në pajtim me nenin 102 paragrafin (2) të këtij ligji.

Neni 111

### **Dispozita kundërvajtëse për kryetarin e komunës**

Gjobë në shumë prej 250 deri 500 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje kryetarit të komunës nëse:

1. nuk përgatit buxhet të përbërë nga pjesa e përgjithshme e buxhetit, pjesa e veçantë e buxhetit dhe projekt dhe pjesë shumëvjeçare të buxhetit, në përputhje me nenin 22 paragrafi (1) të këtij ligji;

2. nuk e përgatit pjesën e veçantë të buxhetit në përputhje me klasifikimin organizativ, programor, ekonomik dhe klasifikimin e burimeve të financimit në përputhje me nenin 24 paragrafi (2) të këtij ligji;

3. nuk publikon raport mujor për realizimin e buxhetit komunal, në përputhje me nenin 91 paragrafi (3) të këtij ligji;

4. nuk dorëzon ose i paraqet jo në kohë Këshillit të Komunës raport për realizimin e buxhetit për gjysmën e parë të vitit, në përputhje me nenin 92 paragrafi (1) të këtij ligji;

5. nuk ka paraqitur ose dorëzuar në kohë të papërshtatshme propozimin ose Llogarinë përfundimtare të miratuar të buxhetit komunal në Ministrinë e Financave, Enti Shtetërorë të Revizionit dhe deri te Këshilli Komunal në përputhje me nenin 94 paragrafët (8), (9), (10) dhe (11) të këtij ligji;

6. nuk i publikon raportin financiar dhe LLogarinë përfundimtare të buxhetit komunal, në përputhje me nenin 94 paragrafi (13) të këtij ligji.

Neni 112

### **Dispozitat kundërvajtëse për ndërmarrjet publike, korporatat e tjera publike, subjektet e tjera publike dhe personat e tjerë juridikë**

Gjobë në shumë prej 400 deri në 500 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit përgjegjës në ndërmarrje publike, subjekt tjetër publik ose person tjetër juridik sipas nenit 79 të këtij ligji nëse:

1. nuk dorëzon plane financiare, raporte dhe deklarata në Ministrinë e Financave, në përputhje me nenin 79 paragrafët (3) dhe (4) të këtij ligji;

2. nuk publikon në faqen e vet të internetit raporte financiare vjetore dhe deklarata, në përputhje me nenin 95 paragrafi (2) të këtij ligji.

#### Neni 113

(1) Nëse kundërvajtje është kryer me mospërbushjen e detyrimit sipas neneve 109, 110, 111 dhe 112 të këtij ligji, kurse kryesi e ka kryer kundërvajtjen për herë të parë në vitin kalendarik dhe nëse kryerësi para miratimit të vendimit për kundërvajtje e ka plotësuar detyrimin e caktuar, do të shqiptohet vërejtje si sanksion kundërvajtëse.

(2) Vërejtja si sanksion kundërvajtëse sipas paragrafit 1 të këtij neni nuk mund të shqiptohet për kundërvajtjet sipas nenit 109 paragrafi (6), (7), (9), (10) dhe (12) i këtij ligji.

#### Neni 114

(1) Organ i autorizuar për paraqitjen e kërkesës për ngritjen e procedurës për kundërvajtje në lidhje me kundërvajtjet sipas neneve 109, 110, 111 dhe 112 të këtij ligji është inspeksioni financiar në sektorin publik.

(2) Nëse inspektori financiar konstaton kundërvajtje, përpilon procesverbal, ku i shënon elementet themelore të veprimit prej ku rrjedh natyra juridike e kundërvajtjes, emri personal, adresa dhe numri i vetëm i amzës së qytetarit, nëse bëhet fjalë për të huajin dhe numrin e dokumentit të udhëtimit dhe shtetit, ndërsa për personin juridik, emrin, selinë dhe numrin tatimor, kohën, vendin dhe mënyrën e kryerjes së kundërvajtjes, përshkrimin e veprimit, kualifikimin juridik të kundërvajtjes dhe personat e gjetur aty për aty, si dhe jep propozim për barazim me lëshimin e urdhërpagesës së kundërvajtjes. Procesverbalin e nënshkruajnë inspektori financiar dhe kryerësi.

(3) Nëse kryerësi nuk pajtohet t'i lëshohet urdhërpagesë për kundërvajtje, kjo do të evidentohet në procesverbalin për kundërvajtje të konstatuar, ndërsa inspektori financiar parashtron kërkesë për ngritje procedurës për kundërvajtje pranë gjykatës kompetente.

(4) Për kundërvajtjet e kryera sipas neneve 109, 110, 111 dhe 112 të këtij ligji, inspektorët financiarë janë të detyruar t'i propozojnë kryesit të kundërvajtjes procedurën për barazim para se të paraqesin kërkesën për procedurë kundërvajtëse, në pajtim me ligjinin për kundërvajtje.

(5) Ministri i Financave e përcakton formën dhe përmbajtjen e urdhërpagesës për kundërvajtje.

#### Neni 115

Për kundërvajtjet të parapara me këtë ligj procedurë kundërvajtës e mban dhe sanksion kundërvajtës shqipton gjykata kompetente.

### XVIII. DISPOZITA KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

#### Neni 116

(1) Dispozita sipas nenit 2 pika 23 të këtij ligji do të ketë periudhë shtesë të harmonizimit prej dy vjetësh nga zbatimi i këtij ligji.

(2) Në periudhën e harmonizimit, këto subjekte sipas paragrafit (1) të këtij neni nuk do të evidentohen në subjektet e pushtetit të përgjithshëm sipas nenit 2 pika 23 të këtij ligji dhe evidentohen në borxh të pushtetit të përgjithshëm në nenin 2 pika 48 të këtij ligji

#### Neni 117

Me rastin e zgjedhjes së përbërjes së parë të anëtarëve të Këshillit Fiskal, mandati i anëtarit të zgjedhur me propozim të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut zgjat dy vjet, i anëtarit të zgjedhur me propozim të Entit Shtetëror të Revizionit për katër vjet, dhe i anëtarit të zgjedhur me propozim të Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Maqedonisë për gjashtë vjet. Në të njëjtën kohë, anëtarët e Këshillit Fiskal, mandati i të cilëve zgjat dy ose katër vjet, kanë të drejtë rizgjedhjeje.

#### Neni 118

Ligjet në të cilat përcaktohen dispozita në lidhje me punën buxhetore dhe financimin do të harmonizohen me dispozitat të këtij ligji në afat prej gjashtë muajve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

#### Neni 119

Me ditën e fillimit të zbatimit të këtij ligji, shfuqizohen dispozitat e Ligjit të Buxheteve (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë numër 64/2005, 4/2008, 103/2008, 156/2009, 95/10, 180/11, 171/12, 192/15 dhe 167/16) dhe Ligjit i Paraqitjes dhe Evidencës së Detyrimeve (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, numër 64/18)

#### Neni 120

Aktet nënligjore të parapara me këtë ligj do të miratohen në afat prej 24 muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

#### Neni 121

Dispozitat e nenit 7, paragrafët (3) dhe (4) dhe dispozitat e nenit 107 të këtij ligji do të fillojnë të zbatohen në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Dispozitat e nenit 6 paragrafët (4), (5) dhe (6), neni 10, neni 11, neni 13, neni 14, neni 16, neni 17, neni 18, neni 19, neni 66 paragrafi (3) dhe paragrafi (4) dhe neni 104 i këtij ligji, do të fillojnë të zbatohen nga 1 janari 2023.

Detyrimet për shfrytëzuesit buxhetorë sipas nenit 13 paragrafët (3) dhe (5), neni 16 paragrafi (3), neni 17 paragrafët (2), (3) dhe (5), neni 18 paragrafi (6), neni 19 paragrafi (1) pika 3 dhe paragrafi (2) nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji deri në ditën e fillimit të zbatimit të këtij ligji, zbatohen nga shfrytëzuesit buxhetorë të përcaktuar në përputhje me Ligjin e Buxheteve (Gazeta Zyrtare e Republika e Maqedonisë numër 64/2005, 4/2008, 103/2008, 156/2009, 95/10, 180/11, 171/12, 192/15 dhe 167/16).

Me ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, shfuqizohen dispozitat e nenit 15, nenit 15-a, nenit 16, nenit 17 dhe nenit 18 të Ligjit të Buxheteve (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë numër 64/2005, 4/2008, 103/2008, 156/2009, 95/10, 180/11, 171/12, 192/15 dhe 167/16).

#### Neni 122

Ky ligj hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e botimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut, kurse do të fillojë të zbatohet nga 1 janari 2025, përveç dispozitave të nenit 121 të këtij ligji.